

# RAPORT

## I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit “Master Profesional” në “Pedagogji” me profile

“Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimit”

Universiteti Privat “Albanian University”

**Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:**

Prof.As.Dr. Mariana Sinani

Dr. Dilina Beshiri

Qershor, 2019

## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

### Për Programin e studimit për programin e studimit "Master profesional" në "Pedagogji" me profile "Didaktikë" dhe "Menaxhim arsimit"

Nr.	Tabela e të dhënave për programin e studimit	
1	IAL Aplikues:	Universiteti Privat "Albanian University"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Shoqërore/ Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKM Nr. 89, datë 10.02.2010 <sup>1</sup> <b>Shkresë e MASR Nr. 6313/2 prot, datë 18.07.2018<sup>2</sup></b>
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	UMASH Nr. 29, datë 31.01.2013/ VKA Nr. 421, datë 11.01.2013
5	Titulli i programit të studimit:	Master profesional në "Pedagogji" me profile "Didaktikë" dhe "Menaxhim arsimit"
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
8	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 7
16	Numri i studentëve	191 studentë [Programi 60 ECTS për vitin 2018-2019: 149 profili "Didaktikë; 42 profili "Menaxhim arsimit".]

<sup>1</sup> Programi është hapur me Vendim Nr. 89, datë 10.02.2018 të Këshillit të Ministrave, si Master i Nivelit të Parë, me kohëzgjatje 1 vit akademik dhe 60 kredite. Programi është riorganizuar nga MNP në MP me Vendim Nr. 192 prot, datë 25.01.2011 të Senatit Akademik dhe është ofruar me kohëzgjatje 1.5 vite akademike, 90 kredite.

<sup>2</sup> Programi është riorganizuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 6, datë 28.02.2018 të UP "Albanian University", për të cilin ka patur dakordësi nga MASR me shkresë nr. 6313/2 prot., datë 18.07.2018. Prej vitit akademik 2018-2019 ofrohet me 60 kredite (ECTS), me kohëzgjatje normale 1 vit akademik.

## HYRJE

### **Të dhëna për programin e studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe Menaxhim arsimit” dhe Universitetin Privat “Albanian University”**

Universiteti Privat “Albanian University” është hapur me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 197, datë 10.04.2004. Përgjatë viteve ky institucion i arsimit të lartë ka pësuar një sërë ndryshimesh si në emërtim dhe në strukturën e tij.

Së fundmi, me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, Nr. 596, datë 21.12.2016 është miratuar Statuti dhe Organigrama e re në përputhje me Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” (sipas Vendimit të Senatit Akademik Nr. 203, datë 28.09.2016 të Universitetit).

Gjithashtu, UP “Albanian University” ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me agjencinë Britanike të sigurimit të cilësisë QAA. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 90, datë 20.10.2017 dhe Universiteti është akredituar me kohëzgjatjen 2 vite, me afat vlefshmërie deri në 19.10.2019. Aktualisht, UP “Albanian University” është në proces vlerësimi në kuadër të akreditimit periodik institucional.

Sipas strukturës së miratuar, UP “Albanian university” përbëhet nga tre Fakultete dhe dhjetë Departamente.

➤ **Fakulteti i Shkencave Shoqërore**

1. Departamenti i Shkencave Politiko - Administrative
- 2. Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme**
3. Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes
4. Departamenti i Shkencave Juridike

➤ **Fakulteti i Shkencave Mjekësore**

1. Departamenti i Stomatologjisë
2. Departamenti i Farmacisë
3. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë

➤ **Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike**

1. Departamenti i Arkitekturës
2. Departamenti i Shkencave Ekonomike
3. Departamenti i Inxhinierive

Për vitin akademik 2018-2019, UP “Albanian University” ofron programe studimi në tre cikle, përkatësisht: 16 programe studimi të ciklit të parë “Bachelor”; 22 programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” dhe “Master i shkencave”; 6 programe studimi të ciklit të tretë “Studime të Doktoratës” dhe “Studime Specializues Afatgjata”.

Programi i studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimit” mbulohet nga **Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes**, ofruar nga Albanian University, **Fakulteti i Shkencave Shoqërore** hapur në vitin akademik 2010-2011 me Vendim Nr. 89, datë 10.02.2010 të Këshillit të Ministrave. Në vitin e parë akademik në këtë program studimi u regjistruan 145 studentë (50 në profilin “Didaktikë” dhe 95 në profilin “Menaxhim arsimit”). Aktualisht për vitin akademik 2018-2019 janë regjistruar 191 studentë në të dy profilet e studimit (149 në profilin “Didaktikë” dhe 42 në profilin “Menaxhim arsimit”).

Ky program studimi, i cili mbulohet nga Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, që në momentin e organizimit të tij ka pasur si mision përgatitjen e mësimit në sistemin parauniversitar dhe përgatitjen e specialistëve dhe drejtuesëve të arsimit në cikle të ndryshëm të arsimit parauniversitar.

“Masteri profesional” në “Pedagogji” me dy profilet e tij në: “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimit” është akredituar për herë të parë me Urdhër Nr. 29, datë 31.01.2013 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, mbështetur në Vendimin e Këshillit të Akreditimit Nr. 421, datë 11.01.2013.

Nga vlerësimi në kuadër të akreditimit, në Vendimin e tij KA ka lënë këto **rekomandime** për programin e studimit “Master profesional” në “Pedagogji”, me profilet “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimit”:

1. Të bëhen përpjekje për të rritur numrin e personelit akademik efektivë në këtë program studimi.
2. Të nxitet kërkimi shkencor brenda departamentit.
3. Të hartohet një plan strategjik për zhvillimin e programit të studimit.
4. Të ngrihet njëسيا e sigurimit të brendshëm të cilësisë.
5. Të realizohen marrëveshje bashkëpunime me ato institucione ku mendohet të kryhet praktika profesionale.

Deri në vitin akademik 2017-2018, programi i studimit është ofruar me 90 kredite (ECTS). Me Vendim të Senatit Akademik Nr. 6, datë 28.02.2018 të Universitetit, programi i studimit “**Master profesional**” në “**Pedagogji**”, me profilet “**Didaktikë**” dhe “**Menaxhim arsimit**” është riorganizuar në **60 kredite (ECTS), me kohëzgjatje 1 vit akademik**. Ky riorganizim është dakordësuar nga ana e Ministrisë me shkresë të MASR Nr. 6313/2 prot, datë 18.07.2018.

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm Periodik (RVJ) është hartuar në vijim të detyrimeve për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të dytë “Master profesional” në “Pedagogji”, me profilet “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimit”, ofruar nga UP “Albanian University”. Në hartimin e këtij Raporti, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është mbështetur në dokumentacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit të përgatitur nga Grupi i Vetëvlerësimit për këtë program studimi, në konstatimet, gjetjet dhe shënimet e mbajtura gjatë takimeve të zhvilluara gjatë vizitave në Institucion, si dhe në dokumentacionin shtesë në kuadër të tyre.

## **GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)**

Përbërja e GVJ: Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: Prof. As. Dr. Mariana Sinani dhe Dr. Dilina Beshiri si ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi. Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL: Znj. Emisa Isufaj.

Universiteti Privat “Albanian University” është njohur me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 29.05.2019, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 10/23 Prot., datë 29.05.2019. UP “Albanian University” përcjell në ASCAL nëpërmjet shkresës me Nr. 338/2 Prot., datë 06.06.2019 komentet në lidhje me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Ekspertët e Vlerësimit u njohën me komentet dhe vendosën të mos ndryshojnë konkluzionet në Draft Raport, me argumentat e mëposhtme:

- 1) **Konstatim i GVJ:** Analizë për plotësimin e rekomandimeve të dhëna nga BA në vendimin për akreditimin e parë, Pika II/b, fq.5: “Institucioni duhet të ketë angazhim në cilësinë e botimeve dhe të iniciativave për konferenca, takime, jo vetëm në pikëpamjen sasiore, se sa në realizimin e bashkëpunimeve dypalëshe me institucionet homologe ndërkombëtare, në fokus të të cilave duhet të jetë pjesëmarrja në projekte dhe mobiliteti i pedagogëve.”

**Komenti i IAL:** Personeli akademik me kohë të plotë dhe me kontratë i Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes është i angazhuar seriozisht në pjesëmarrje në aktivitete me karakter kërkim shkencor, leksione të hapura, konferenca studentore, dhe workshope dhe ekspozita si dhe botime me vlerë në fushën e pedagogjisë (Evidenca nr. 1). Studimet e realizuara nga stafi akademik janë të publikuara në revista kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe të prezantuara në konferenca shkencore të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu, departamenti ka punuar në zgjerimin e marrëveshjeve

të bashkëpunimit me Institucione brenda dhe jashtë vendit duke u angazhuar në projekte shkencore (Referohu Dokumentit plotësues nr.3). Stafi Akademik i këtij departamenti ka bërë përpjekje për përfitim të projekteve ndërkombëtare duke aplikuar dhe duke qënë pjesë e disa projekteve (Evidencë nr.2).

**Përgjigjja GVJ:**

**GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit në këtë drejtim, por i qëndron arsytetimeve dhe përfundimeve të dhëna në Draft Raport.**

2) **Konstatim i GVJ:** Analizë për plotësimin e rekomandimeve të dhëna nga KA në vendimin për akreditimin e parë, Pika II/e, fq.6: “Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me DAR Tiranë dhe disa Institucione të Arsimit Parauniversitar për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës Master profesional në Pedagogji me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim Arsimi”. Në këtë kuadër, janë hartuar marrëveshje gjatë muajit mars 2019, të cilat ende nuk kanë dhënë akses në program.”

**Komenti I IAL:** Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes është angazhuar në realizimin dhe vendosjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit midis institucioneve homologe apo institucioneve bashkëpunuese në kuadër të praktikave profesionale. Praktikave profesionale janë zhvilluar më së miri edhe në kushtet kur midis institucioneve nuk kanë qënë të lidhura marrëveshjet e bashkëpunimit.

**Përgjigjja GVJ:**

**GVJ vlerëson dhe inkurajon me tej përpjekjet e institucionit në drejtim të formalizimit të bashkëpunimit me institucione të tjera për realizimin e praktikave profesionale me argumentin që praktika profesionale është dimension substancial i programit. Për sa më sipër, GVJ i qëndron arsytetimeve përgjatë raportit.**

3) **Konstatim i GVJ:** Fusha I, fq.7-8-9: “Master profesional në Pedagogji me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim Arsimi” është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës por me hyrjen në fuqi të Ligjit të Arsimit nr. 80/2015, Neni 38 për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë lind nevoja për të përshtatur këtë program me politikën kombëtare të cilat diktojnë tregun e punës. Duhet specifikuar në mënyrë të qartë e të ndarë synimin dhe objektivat për të kualifikuar mësuesin në ciklin fillor dhe mësuesin për arsimin e mesëm të ulët dhe për arsimin e mesëm të lartë.

Emërtimi i programit të studimit Master Profesional është në përputhje me nivelin 7 të kualifikimit të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit, por titulli “Didakt” mbetet për t’u analizuar. Titulli i diplomës “Didakt” nuk ofrohet në listën e profesioneve të rregulluara, referuar ligjit të datës 22 tetor 2009. Rregullorja e programit dhe Kontrata me studentët e kanë lënë jashtë këtë fakt. Në kushtet aktuale programet e studimit për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë duhet të organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, me kredit, sipas fushave përkatëse të formimit.”

**Konstatim i GVJ:** Fusha 7, Konkluzione, fq.29: Në momentin e licensimit dhe akreditimit të parë të Masterit Profesional në Pedagogji me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim Arsimi”, misioni dhe objektivat për kualifikimin e mësuesve në cikle të ndryshme të sistemit parauniversitar ishin të specifikuar qartë, por me hyrjen në fuqi të Ligjit të Arsimit të Lartë nr. 80/2015 dhe me Ligjin nr. 48/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor

parauniversitar” programi i studimit Master Profesional në Pedagogji me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim Arsimi”, nuk specifikon qartë ciklin dhe disiplinën përkatëse në të cilin do të zhvillojë mësimdhënien student i diplomuar.

**Komenti i IAL:** Përgjigje konkluzioneve fusha 1 dhe 7: Programi i studimit Master profesional në Pedagogji me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim Arsimi” në kuadër të riorganizimit të tij në përputhje me aktet ligjore në fuqi është miratuar nga MASR me shkresë nr. 6313/2 prot, datë 18.07.2018. Në Rregulloren e Programit të studimit Master Profesional në Pedagogji me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim Arsimi” specifikohet që mbajtësi i kësaj diplome mund të ushtrojë veprimtari të tilla:

1. Mësues i specializuar në didaktikë.
2. Trainues metodik në shkolla.
3. Specialist metodist ne institucionet parashkollore.
4. Specialist metodist ne institucionet e riedukimit.
5. Inspektor për mësimdhënien në drejtoritë rajonale arsimore.

**Përgjigjja GVJ:**

**GVJ vazhdon t’i qëndrojë arsyetimeve të parashturara përgjatë raportit lidhur me çështjet e mësipërme.**

**4) Konstatim i GVJ:** Fusha 3, fq.12: Dr. H.M. pavarësisht se është në cilësinë e Koordinatorit të programit të studimit Master profesional në Pedagogji me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim Arsimi” nuk figuron në stafin akademik të angazhuar për realizimin e këtij programi studimi.

**Komenti i IAL:** Qartësojmë se Dr. H.M. është pedagog i angazhuar për Praktikat që zhvillojnë studentët e programit të studimit Master profesional në Pedagogji me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim Arsimi” (Referohu RVB faqe 67)

**Përgjigjja GVJ:**

**GVJ i qëndron arsyetimit se nëse Koordinatori i programit do të ishte pjesë e stafit mësimdhënës, kjo do të rriste cilësinë e programit të studimit.**

**5) Konstatim i GVJ:** Fusha 3, Konkluzione, fq.16: “Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programin e studimit Master profesional në Pedagogji me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim Arsimi” përbën 58 % të personelit akademik të angazhuar për realizimin e këtij programi studimi, ndërsa personeli akademik PAK tejkalon ngarkesën e përcaktuar në këtë udhëzim për stafin e angazhuar me kohë të pjesshme.”

**Komenti i IAL:** Stafi akademik me kohë të plotë në programin e studimit Master profesional në Pedagogji me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim Arsimi” mbulon në përqindje 74 % të ngarkesës mësimore dhe 26 % i mbulon stafi akademik me kohë të pjesshme në përputhje me Udhëzimin nr. 418 datë 10.05.2017. Për sa i përket raportit në numër të personelit akademik, nuk është detyrim ligjor.

**Përgjigjja GVJ:**

**GVJ e konsideron të balancuar raportin mes stafit PAE/PAK nga viti akademik në vitin akademik. Këto arsytetime ngrihen mbi të dhënat e RVB dhe konstatime përgjatë vizitës në institucion.**

**6) Konstatim i GVJ:** Fusha 4, Konkluzione, fq.19: Titujt e literaturës në funksion të studentëve të programit të studimit Master profesional në Pedagogji me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim Arsimit” për realizimin e projekteve kërkimore dhe realizimit të tezës së diplomës janë të reduktuara. Nuk ka informacion dhe instrumenta për të matur se sa studentë kanë akses në librarinë on-line Qestia.

**Komenti i IAL:** Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes pasuron vazhdimisht bibliotekën me tituj të rinj tekstesh në funksion të programit të studimit (Referohu Evidencës nr. 4 Dosja e Dokumentave). Për sa i përket realizimit të projekteve dhe temave të diplomës studentët mbështeten në literaturë shtesë mundësuar nga ana e pedagogëve udhëheqës dhe patjetër nga aksesimi i bibliotekave online.

**Përgjigjja GVJ:**

**GVJ i qëndron arsytetimeve të shprehur në Draft RVJ. Kjo u evidentua gjatë vizitës në institucion, ku u kontaktua me botimet në fushën e didaktikës dhe menaxhimit të arsimit të cilat, rezultojnë relativisht të reduktuara në numër dhe cilësi.**

**7) Konstatim i GVJ:** Fusha 5, Konkluzione, fq.20: Raporti i auditit financiar bëhet në nivel institucioni e si rrjedhojë nuk ka një raport me të dhëna të hollësishme financiare për realizimin e programit të studimit të Masterit Profesional. Nuk konstatoam të ketë qoftë dhe një buxhet modest për grantet kërkimore shkencore dhe shërbimet trajuese.

**Komenti i IAL:** Departamenti në fillim të vitit akademik harton një propozim mbi nevojat për realizimin vjetor të programeve të studimit që ofron. Në këtë shkresë specifikon zërat dhe buxhetin që i duhet për secilën nga veprimtaritë që do të realizojë përgjatë vitit akademik. Bordi administrative shqyrton dhe miraton kërkesën e departamentit duke e përfshirë në buxhetin vjetor (Evidencë nr.3).

**Përgjigjja GVJ:**

**GVJ i qëndron mendimit të shprehur në Draft Raport.**

**8) Konstatim i GVJ:** Fusha 10, Konkluzione, fq.7-8-9: “Institucioni disponon një raport individual të stafit akademik për aktivitetet dhe botimet shkencore por nuk na është vënë në dispozicion asnjë dokument që të dëshmojë se ekziston një bazë të dhënash.”

**Komenti i IAL:** Stafit akademik paraqet në fillim të çdo viti akademik pranë Departamentit Formularët e Planifikimit të aktiviteteve si: konferenca e aktivitetet të tjera kërkimore shkencore të cilat ka planifikuar të kryejë në atë vit akademik. Gjithashtu, në përfundim të vitit akademik çdo anëtar i personelit akademik dorëzon pranë Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes Formularët e veprimtarisë së zhvilluar, të cilët përmbajnë të gjitha aktivitetet shkencore si: botime në revista, pjesëmarrje në projekte, aplikime në projekte etj., të kryera nga pedagogu përkatës në atë vit akademik. Këta formularë depozitohen dhe depozitohen në dosjen e kërkimit shkencor pranë

Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes dhe vlerësohen nga drejtuesi i departamentit në funksion të vlerësimit të performancës së tyre akademike. (Evidencë nr.4)

### **Përgjigjja GVJ:**

**GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit në këtë drejtim. Evidencat nga IAL paraqesin formularë të vlerësimit individual të stafit për pjesëmarrjen në aktivitete dhe botimet shkencore, por nuk mund të konsiderohet si bazë të dhënash.**

## **ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË**

### **I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit**

- a) Të bëhen përpjekje për të rritur numrin e personelit akademik efektivë në këtë program studimi.
- b) Të nxitet kërkimi shkencor brenda departamentit.
- c) Të hartohet një plan strategjik për zhvillimin e programit të studimit.
- d) Të ngrihet njëسيا e sigurimit të brendshëm të cilësisë.
- e) Të realizohen marrëveshje bashkëpunime me ato institucione ku mendohet të kryhet praktika profesionale.

### **II. Plotësimi i tyre nga Institucioni**

- a) **Për rekomandimin: Të bëhen përpjekje për të rritur numrin e personelit akademik efektivë në këtë program studimi,** institucioni ka ndërmarrë masa ndër vite për rritjen dhe qëndrueshmërinë e personelit akademik në mbështetje të realizimit të programit “Master profesional” në “Pedagogji”, me profilet “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimit”. Konkretisht:  
Për vitin akademik 2018-2019 stafi i angazhuar në programin e studimit përbëhet nga 7 pedagogë efektiv (PAE: 1 Prof. Asoc, 5 Dr dhe 1 Msc) dhe 5 Pedagogë me kontratë (PAK: 1 Prof.Dr, 1 Prof.Asoc, 2 Dr, 1 Msc).

Për vitin akademik 2017-2018, janë angazhuar 7 pedagogë efektivë (PAE: 1 Prof.As. Dr.; 6 Dr) dhe 4 pedagogë me kontratë (PAK: 2 Prof. As. Dr.; 2 Dr.)

Për vitin akademik 2016-2017, janë angazhuar 8 pedagogë efektivë (PAK: 1 Prof.As.Dr.,; 7 Dr.) dhe 4 pedagogë me kontratë (PAK: 3 Prof.As.Dr.; 1 Dr.)

Për vitin akademik 2015-2016, janë angazhuar 5 pedagogë efektivë (PAE: 1 Prof.Dr.; 3 Prof.As.Dr.; 1 Dr.) dhe 3 pedagogë me kontratë (PAK: 1 Prof.As.Dr.; 1 Dr.; 1 Msc.)


Për vitin akademik 2014-2015, janë angazhuar 5 pedagogë efektivë (PAE: 1 Prof.Dr.; 3 Prof.As.Dr.; 1 Dr.) dhe 1 pedagog me kontratë (PAK: 1 Prof.As.Dr.)

Për vitin akademik 2013-2014, 1 pedagog efektiv (PAE: 1 Prof.As.Dr.) dhe 6 pedagogë me kontratë (PAK: 6 Prof.As.Dr.; 1 Dr., 1 Msc)

*Numri i pedagogeve nga viti 2013 ka ardhur në rritje dhe tre vitet e fundit ka stabilitet të stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme. Për sa më sipër, GVJ arrin në konkluzionin se rekomandimi është përmbushur.*



- b) **Për rekomandimin:** Të nxitet kërkimi shkencor brenda departamentit, stafi akademik i Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes është angazhuar në kërkimin shkencor në disiplinat përkatëse të formimit duke marrë pjesë në Konferencat Kombëtare dhe Ndërkombëtare të organizuara nga institucioni dhe botime në revistën shkencore periodike "Optime" të institucionit. Por, mendojmë që, institucioni duhet të ketë angazhim në cilësinë e botimeve dhe të iniciativave për konferenca, takime, jo vetëm në pikëpamjen sasiore, se sa në realizimin e bashkëpunimeve dypalëshe me institucionet homologe ndërkombëtare, në fokus të të cilave duhet të jetë pjesëmarrja në projekte dhe mobiliteti i pedagogëve. Për sa më sipër, GVJ arrin në konkluzionin se rekomandimi është përmbushur pjesërisht.
- c) **Për rekomandimin:** Të hartohet një plan strategjik për zhvillimin e programit të studimit. Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes ka hartuar një plan strategjik katër vjeçar (2016-2020) për programin e studimit "Master profesional" në "Pedagogji" me profil në "Didaktikë" dhe "Menaxhim arsimit", në të cilin përcaktohet vizioni, misioni dhe objektivat për mësimdhënien dhe mësimnxënien, programin mësimor dhe kërkimin shkencor. Nuk na rezultojnë të ketë ndryshime substanciale të një plani strategjik, krahasuar me planin fillestar. Për sa më sipër, GVJ arrin në konkluzionin se rekomandimi është pjesërisht.
- d) **Për rekomandimin:** Të ngrihet njësi e sigurimit të brendshëm të cilësisë, institucioni ka krijuar zyrën e sigurimit të brendshëm të cilësisë ZSBC në fillim të vitit akademik 2009-2010. Me hyrjen në fuqi të Ligjit 80/2015 Për Arsimin e Lartë është ngitur me vendim të Senatit Akademik (Nr.4, dt.22/12/2016) Komisioni i Përhershëm për Vlerësimin Institucional. NjSBC ushtron funksion mbështetës, monitorues, vlerësues si dhe ofron ekspertizë për zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë. Gjithashtu NjSBC ka funksion të hartojë politikat e vetëvlerësimit dhe të përcaktojë kriteret e vlerësimit, të cilat realizohen nëpërmjet anketimeve dhe raporteve vlerësuese. Që prej vitit 2016, NjSBC, në bashkëpunim me departamentet funksionon, ngirhet një komisionin Ad-hoc, në nivel njësie bazë, për të vlerësuar programet mësimore, literaturën, format e vlerësimit. Na rezultojnë se ky rekomandim është përmbushur cilësisht.
- e) **Për rekomandimin:** Të realizohen marrëveshje bashkëpunime me ato institucione ku mendohet të kryhet praktika profesionale, institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me DAR Tiranë dhe disa Institucione të Arsimit Paruniversitar për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës Master Profesionale në profilin Didaktikë dhe Menaxhim Arsimit. Në këtë kuadër, janë hartuar marrëveshje gjatë muajit mars 2019, të cilat ende nuk kanë dhënë akses në program. Departamenti harton një raport analitik në të cilin analizohen përfitimet nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të këtij program studimi. Për sa më sipër, GVJ arrin në konkluzionin se rekomandimi është përmbushur kryesisht!



## 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

### Pjesa përshkrimore

Programi i studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimit” ka si mision të formojë mësimdhënës të cikleve të ndryshëm të studimeve në sistemin parauniversitar nëpërmjet përdorimit të metodave bashëkohore të mësimdhënies si dhe të formojë drejtues dhe menaxherë të arsimit bazuar në parimet etike profesionale.

Objektivat e këtij program studimi synojnë të përgatisin mësimdhënës të ciklit fillor, mësimdhënës të ciklit të mesëm të ulët e të mesëm të lartë, ekspert dhe drejtues të arsimit parauniversitar nëpërmjet plan programit me 60 ECTS me karakter psiko pedagogjik pavarësisht formimit bachelor në profile të ndryshme.

Qëllimi dhe objektivat e këtij program studimi, në kuadër të përgjithshëm, synojnë të përshtasin kurrikulën, metodat e mësimdhënies si dhe praktikën profesionale në mënyrë që të përshtaten me nevojat aktuale të kërkesave të formimit dhe zhvillimit akademik të mësuesve dhe drejtuesve të sistemit arsimor parauniversitar në shërbim të ndryshimeve dinamike sociale dhe ekonomike që po pëson vendi. Ky program studimi synon të nxisë studentët të zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues nëpërmjet metodave të mësimdhënies në zgjidhjen e situatave reale të ndeshura gjatë zhvillimit të praktikës në shkollat e ciklit parauniversitar. [Evidencë: **Plani Strategjik i programit, 2016-2020**]

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh</b>	<b>në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit; <b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës; <b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit; <b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	<b>Konfirmojmë që:</b> Master Profesional në Pedagogji me profil “Didaktikë” dhe Menaxhim Arsimit” është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit.  <b>Konfirmojmë që:</b> Master Profesional në Pedagogji me profil “Didaktikë” dhe Menaxhim Arsimit” është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës [Evidenca “Analizë e tregut të punës”-periudha e analizuar 2013-2018] por me hyrjen në fuqi të Ligjit të Arsimit nr.80/2015, Neni 83 për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë lind nevoja për të përshatur këtë program me politikat kombëtare të cilat diktojnë tregun e punës.  <b>Konfirmojmë që:</b> Master Profesional në Pedagogji me profil “Didaktikë” dhe Menaxhim Arsimit” është hartuar në përputhje me nevojat ekonomike të vendit e cila reflektohet në qëllimet dhe objektivat e institucionit për hartimin e programeve të studimit në shërbim të nevojave kombëtare.  <b>Konfirmojmë që:</b> Master Profesional në Pedagogji me profil “Didaktikë” dhe Menaxhim Arsimit” pasqyron vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit mbi të cilat mbizotëron dimensionin fisnik dhe human i mësimdhëniesit.
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	

<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Programi i studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimit” është përshtatur në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit për rritjen e cilësisë së mësimdhënies.</p>
<p><b>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Programi i studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimit” ishte në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në momentin e licensimit dhe akreditimin të parë në 2012, me hyrjen në fuqi të Ligjit për Arsimit e Lartë Nr. 80/2015 dhe me ligjin nr. 48/2018 për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar” duhet specifikuar në mënyrë të qartë e të ndarë synimin dhe objektivat për të kualifikuar mësimdhënësit në ciklin fillor dhe mësimdhënës për arsimin e mesëm të ulët dhe për arsimin e mesëm të lartë.</p> <p><b>Konfirmojmë që:</b> Emërtimi i programit të studimit Master Profesional është në përputhje me nivelin 7 të kualifikimit të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimi, por titulli i diplomës “Didakt” mbetet për t’u analizuar.</p> <p>Titulli i diplomës “Didakt” nuk ofrohet në listën e profesioneve të rregulluara, referuar ligjit të datës 22 tetor 2009. <b>Rregullorja e programit dhe Kontrata me studentët</b> e kanë lënë jashtë këtë fakt.</p>
<p><b>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p><b>Konfirmojmë që:</b> Institucioni ka hartuar një plan strategjik për zhvillimin e programeve të studimit. Objektivat strategjike që ka përcaktuar institucioni në këtë dokument, lidhen ndër të tjera me: Mësimdhënien, kurrikulat dhe mësimnxënien me në qendër formimin e studentëve; Kërkimin shkencor dhe inovacionin; Sigurimin e brendshëm të cilësisë, etj., të cilat synohen të arrihen brenda 5 viteve të ardhshme nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore dhe të kulturës së cilësisë, favorizimin e metodave interaktive të mësimdhënies të cilat inkurajojnë të menduarin kritik dhe vendosin studentin në qendër të mësimdhënies, nëpërmjet financimit të studimeve të doktoratës për në pjesë të stafit pranë universiteteve perëndimore, mobiliteteve, etj. [Evidenca “<b>Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional, 2017-2022</b>”].</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b></p>	
<p>Programi i studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” ka si mision të formojë mësimdhënës të cikleve të ndryshëm të studimeve, por nuk specifikon ciklin dhe disiplinën në të cilin do të zhvillojë mësimdhënien studentit i diplomuar.</p> <p>Studenti i diplomuar si “Didakt” ka një profil gjeneralist, ekspert në didaktikë, referuar titullit të diplomës, gjë që përgjatë sylabuseve, Didaktika si shkencë e mësimdhënies përfshirë taksonomitë, nuk del specifikisht, por ezaurohet tek mësimdhënja dhe metodologjitë.</p> <p>“Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimit” është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës por me hyrjen në fuqi të Ligjit të Arsimit nr.80/2015 dhe Ligjit të Arsimit Universitar e zbeh këtë raport. Në kushtet aktuale programet e studimit për formimin e mësuesve të arsimit të</p>	

mesëm të ulët dhe të lartë duhet të organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", me 120 kredite, sipas fushave përkatëse të formimit.

Titulli i diplomës "Didakt" mbetet për t'u analizuar në pikëpamjen e sylabuseve.

Konstatohet që Institucioni ka hartuar objektiva 5 vjeçarë për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, konkretizimi i tyre mbetet që të vlerësohet me kohën.

## 2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

### Pjesa përshkrimore

Fakulteti i Shkencave Shoqërore është një nga tre njësitë kryesore të Albanian University. Fakulteti ofron programe të studimeve të llojeve dhe niveleve të ndryshme në përfundim të të cilave përfitohet diplomë sipas ciklit përkatës. Fakulteti përbëhet nga autoritetet drejtuese, organet drejtuese, njësitë bazë mësimore - shkencore dhe nga administrata. Fakulteti ka në përbërjen e tij katër njësi bazë. Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes është një nga katër njësitë bazë të këtij fakulteti. Personeli akademik i fakultetit përbëhet nga profesorë, lektorë dhe asistent-lektorë me kohë të plotë dhe të pjesshme, si dhe personel akademik i ftuar. Të dhënat e përgjithshme për organizimin institucionit, bëhen publik, çdo fillim viti akademik edhe në websitin e universitetit (<https://albanianuniversity.edu.al/sq/kreu/>). [Evidencë: "Statuti AU"; "Rregullore e Fakultetit, 2016"].

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

#### **Struktura akademike e Fakultetit**

Fakulteti i Shkencave Shoqërore si pjesë e strukturës së përgjithshme në Albanian University, është një nga njësitë kryesore mësimore e kërkimore, ku Dekani është autoriteti drejtues i cili drejton punën mësimore dhe shkencore në këtë fakultet. Autoritete të tjera drejtuese në këte fakultet janë Zv.Dekani dhe Shefat e Departamenteve të fakultetit. Fakulteti ofron programe të studimeve të nivelit të parë "Bachelor" dhe të ciklit të dytë "Master profesional" dhe "Master i shkencave". Sipas skemës aktuale, Fakulteti i Shkencave Shoqërore ka në përbërjen e tij katër njësi bazë mësimore-shkencore: Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, Departamenti i Shkencave Juridike, Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative, të cilët udhëhiqen nga një përgjegjës departamenti. (Tabela 1- Aneksi bashkëngjitur).

**Për vitin akademik 2018-2019:** në Fakultetin e Shkencave Shoqërore angazhohen **38 PAE** dhe **73 PAK** si dhe 26 personel administrativ. Njësitë bazë të këtij fakulteti plotësojnë kriterin ligjor për numrin dhe kualifikimin e personelit akademik efektiv, sikurse konstatohet në analizën më poshtë [Tabelat 1; 1.1; 1.2; 1.3; 1.4 Aneks]:

- Në Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme, angazhohen 10 PAE ( 1 Prof. As.; 2 Dr.; 4 Msc.), 19 PAK ( 1 Prof. Dr.; 2 Prof. As.; 12 Dr.; 4 Msc.).
- Në Departamentin e Edukimit dhe Anglishtes, angazhohen 10 PAE (2 Prof. As.; 8 Dr.), 14 PAK ( 1 Akademik i Asociuar; 2 Prof. Dr.; 3 Prof. As.; 6 Dr.; 3 Msc.).
- Në Departamentin e Shkencave Politiko-Administrative, angazhohen 8 PAE ( 1 Prof. Dr.; 6 Dr.; 1 Msc), 20 PAK ( 1 Prof. Dr.; 3 Prof. As.; 9 Dr.; 7 Msc.).
- Në Departamentin e Shkencave Juridike, angazhohen 10 PAE ( 2 PhD., 3 Dr.; 5 Msc.), 20 PAK ( 2 Prof. Dr.; 2 Prof. As.; 1 PhD., 6 Dr.; 1 Magjister, 8 Msc.)

#### **Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës**

Programi i studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimi” ofrohet nga Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes. Ky Departament drejtohet nga Përgjegjësi i Departamentit.

Për vitin akademik **2013-2014**, numri i pedagogëve në këtë departament ka qënë 56 PAE (1 Dr.; 2 Prof. As.; 14 në proces doktrature; 35 Master i shkencave; 4 Ma) dhe 39 PAK (4 Prof.As; 2 Specializim; 10 Dr.; 7 ne proces doktrature; 15 Master i shkencave; 1 Ma.).

Për vitin akademik **2014-2015**, numri i pedagogëve në këtë departament ka qënë 18 PAE (3 Prof. As.; 4 Dr.; 6 ne proces doktrature; 4 Msc, 1 Ma) dhe 49 PAK (1 Prof. Dr.Akademik; 1 Prof.Dr.; 4 Prof. As.; 2 Specializim; 6 Dr., 9 ne proces doktrature; 22 Msc; 2 Ma; 2 Bsc).

Për vitin akademik **2015-2016**, numri i pedagogëve në këtë departament 20 PAE (3 Prof. As.; 7 Dr, 7 ne proces doktrature, 3 Msc) dhe 34 PAK (1 Prof Akademik; 1 Prof Dr; 3 Prof.As.; 1 Specializim; 7 Dr.; 4 ne proces doktrature; 15 Msc; 2 Ma).

Për vitin akademik **2016-2017**, numri i pedagogëve në këtë departament 13 PAE (2 Prof. As.; 7 Dr.; 1 PhD; 2 ne proces doktrature; 1 Msc) dhe 15 PAK (1 Prof.Dr; 3 Prof.As.; 4 Dr.; 2 ne proces doktrature; 1 Ma; 4 Msc).

Për vitin akademik **2017-2018**, numri i pedagogëve në këtë departament (2 Prof. As.; 8 Dr.) dhe 16 PAK (1 Prof. Dr.; 3 Prof.As.; 8 Dr.; 4 Msc).

Numri i stafit akademik efektiv në këtë departament, **për vitin akademik 2018-2019** është 10 pedagoge me kohë të plotë (2 Prof. Asoc dhe 8 Dr) dhe 14 pedagogë me kohë të pjesshme ( 1 Akad.Asoc, 2 Prof.Dr., 2 Prof. Asoc. dhe 6 Dr. Dhe 3 Msc.).

Numri i pedagogeve nga viti 2013 ka ardhur në rritje, në mënyre cilësore, dhe tre vitet e fundit ka stabilitet të stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme.

(Tabela 2: Personeli akademik në njësinë bazë – Aneksi bashkëngjitur)

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>Albanian University organizohet në mënyrë që të përmbushë me efektivitet misionin primar, zhvillimin dhe rritjen e mësimdhënies në shërbim të studentit.</p> <p><b>Konfirmojmë që:</b> Albanian University ka në përbërje të tij tre fakultete: Fakulteti i Shkencave Shoqerore, Fakulteti i Shkencave Mjekësore dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, konform kërkesave ligjore për njësitë kryesore përbërëse të një institucion të arsimit të lartë të llojit “Universitet”.</p> <p><b>Konfirmojmë që:</b> Fakulteti i Shkencave Shoqerore ka në përbërje të tij katër njësi bazë: Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, Departamenti i Shkencave Juridike, Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme,</p>

	<p>Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative. Nga planet strategjike për zhvillimin e secilit departament që Fakulteti i Shkencave Shoqërore ofron rezultun se departamentet funksionojnë në bazë të rregulloreve të veçanta me misione dhe objektiva të mirëpërcaktuara.</p> <p>Rezultun se: Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes ka në përberje të tij 10 pedagogë me kohë të plotë (2 Prof. Asoc dhe 8 Dr), duke plotësuar kriteret ligjore dhe nënligjore në fuqi për numrin dhe kualifikimin e stafit akademik në njësinë bazë që e ofron këtë program studimi.</p> <p>Edhe gjatë periudhës 2013 – 2018 rezultun se kërkesat ligjore për numrin e personelit akademik efektiv në njësinë bazë plotësohet, vihet re qëndrueshmëria e stafit akademik të departamentit në vitet e fundit si dhe përmbushja e shkallës së kualifikimit.</p>
<p><b>Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Njësitë bazë dhe kryesore rezultun se janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve që ofrojnë, konkretisht për realizimin e programit “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimit”. Anëtarët e njësisë bazë dhe kryesore transmetojnë përgjegjëshmëri dhe standarte të larta për realizimin e procesit të mësimdhënies dhe arrijen e objektivave të programit të studimit.</p> <p>Njësitë bazë dhe kryesore rezultun të jenë të përfshira në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm sipas procedurave të kodit të punës dhe rregulloreve të institucionit. [Evidenca: <b>Procedurë rekrutimi, 2018-2019; Takimet gjatë vizitave</b>]</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p><b><u>Konfirmojmë se:</u></b> Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes plotësojnë kriteret ligjore dhe nënligjore në fuqi për funksionimin e tyre.</p> <p>“Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimit” është në përputhje me planin strategjik për zhvillimin e institucionit dhe zhvillimin e njësisë bazë gjithashtu.</p> <p>Njësitë bazë dhe kryesore funksionojnë në bazë të rregulloreve të veçanta me misione dhe objektiva të mirëpërcaktuara. Anëtarët e njësisë bazë dhe kryesore përcjellin standarte të larta për realizimin e procesit të mësimdhënies dhe arrijen e objektivave të programit të studimit.</p>	

### 3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

#### Pjesa përshkrimore

Stafi akademik i “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimit” ndahet në personel akademik me kontratë dhe personel akademik efektiv.

Për vitin akademik **2013-2014** stafi akademik i angazhuar në mësimdhënien e programit të studimit, përbëhet nga 1 PAE (Prof.As.) dhe 6 PAK (4 Prof. As; 1 Dr; 1 ne proces doktorature).

Për vitin akademik **2014-2015** stafi akademik i angazhuar në mësimdhënien e programit, 5 PAE (1 Prof. Dr.; 3 Prof. As.; 2 Dr) dhe 1 PAK (1 Prof. As.).

Për vitin akademik **2015-2016** stafi akademik i angazhuar në mësimdhënien e programin e studimit, 5 PAE (1 Prof.Dr.; 3 Prof. As.; 1 Dr.) dhe 3 PAK (1 Prof.As.; 1 Dr.; 1 ne proces doktorature).

Për vitin akademik **2016-2017** stafi i angazhuar në mësimdhënien e programit 8 PAE (1 Prof. As.; 7 Dr.) dhe 4 PAK (3 Prof. As.; 1 Dr.).

Për vitin akademik **2017-2018** stafi i angazhuar në mësimdhënien e programit të studimit 7 PAE (1 Prof. As.; 6 Dr.) dhe 4 PAK (2 Prof. As.; 2 Dr.).

Për vitin akademik **2018-2019** stafi i angazhuar në mësimdhënien të “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimit” përbëhet prej 7 pedagogë efektiv (PAE: 1 Prof. Asoc, 5 Dr dhe 1 Msc) dhe 5 Pedagogë me kontratë (PAK: 1 Prof.Dr, 1 Prof.Asoc, 2 Dr, 1 Msc)

**(Tabela 3: Cilësia e stafit drejtues, mësimdhënës dhe administrativ për programin e studimit – Aneks)**

Departamenti i Edukimi dhe Anglishtes tre vitet e fundit akademike 2016-2017, 2017-2018, 2018-2019 rezultojnë të ketë qëndrueshmëri të stafit akademik efektiv kjo edhe si rrjedhojë e shtimit të numrit të studentëve të regjistruar në këtë program studimi nga viti në vit. [Evidencë: **Tabela 2: Personeli akademik në njësinë bazë**].

Procedurat për rekrutimin e stafit akademik ndjekin shkallën hierarkike nga kërkesa e departamentit e cila i paraqitet dekanatit, i cili përcjell kërkesat në rektorat për përcaktimin dhe miratimin e kriterëve të pranimit jo vetëm në fillim të vitit akademik, siç rezultojnë nga RVB për vitin akademik 2018-2019, por edhe në fillim të semestrit të dytë akademik në bazë të nevojave të departamentit.

Nga konsultimi i dokumentacionit të kërkuar gjatë vizitës në institucion në lidhje me shpërndarjen e ngarkesës mësimore të programit të studimit, rezultojnë se:

Për ngarkesën mësimore në vitin akademik **2016-2017**, PAE mbulonte 61% kurse PAK 39%.

Për ngarkesën mësimore në vitin akademik **2017-2018**, PAE mbulonte 61% dhe PAK, 39%.

Për ngarkesën mësimore në vitin akademik **2018-2019**, PAE mbulon **74.6% kurse PAK, 25.4%**.

[Evidencë: **Procedurë rekrutimi, 2018-2019; Takimet gjatë vizitave; Shpërndarja e ngarkesës mësimore PAK/PAE: 2016-2017, 2017-2018, 2018-2019**]

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat.**  
Për vitin akademik 2018-2019 stafi në mbështetje të “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimit” përbëhet prej 7 pedagogë efektiv (PAE: 1 Prof. Asoc, 5 Dr dhe 1 Msc) dhe 5 Pedagogë me kontratë (PAK: 1 Prof.Dr, 1 Prof.Asoc, 2 Dr, 1 Msc).  
**(Tabela 3- Aneksi bashkëngjitur)**
- Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinatorit të programit të studimit**  
Nga vizita në institucion rezultoi se Këshilli Shkencor i Programit konsiderohet i gjithë personeli akademik efektiv i departamentit. Koordinatorin e programit të studimit “Master profesional” në “Pedagogji”, me dy profile, është Dr. H.M., propozuar nga Përgjegjësi i Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes, miratuar nga Dekani i Fakultetit të Shkencave Shoqërore me shkresë nr. 972/1 prot, Dt. 17/10/2018. *Rezultojnë se Dr. H.M. pavarësisht se është në cilësinë e Koordinatorit të programit të studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimit” nuk figuron në stafin akademik të angazhuar për realizimin e këtij program studimi.*
- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre**

Rezultoni se stafi akademik PAE dhe PAK në programin e studimit "Master profesional" në "Pedagogji" me profil "Didaktikë" dhe "Menaxhim arsimit" është me tituj dhe me grada sipas akteve ligjore në fuqi. Konstatohet që nga viti 2013 stafi akademik është i qëndrueshëm. (Tabela 4- Aneksi bashkëngjitur)

Në vitin akademik 2013 -2014, raporti me PAE dhe PAK të angazhuar në programin e studimit është 1:6 (PAE: 14% dhe PAK: 86%).

Në vitin akademik 2014 -2015, raporti me PAE dhe PAK të angazhuar në programin e studimit është 5:1 (PAE: 83% dhe PAK: 17%).

Në vitin akademik 2015 -2016, raporti me PAE dhe PAK të angazhuar në programin e studimit është 5:3 (PAE: 62.5% dhe PAK: 37.5%).

Në vitin akademik 2016 -2017, raporti me PAE dhe PAK të angazhuar në programin e studimit është 8:4 (PAE: 67% dhe PAK: 33%).

Në vitin akademik 2017 -2018, raporti me PAE dhe PAK të angazhuar në programin e studimit është 7:4 (PAE: 64% dhe PAK: 36%).

Në vitin akademik 2018 -2019, raporti me PAE dhe PAK të angazhuar në programin e studimit është 7:5 (PAE: 58% dhe PAK: 42%)

Numri i stafit akademik të brendshëm të angazhuar në program ka qënë më i lartë në periudhën 2014-2018., duke ruajtur një raport afër 70 %. Vitin e fundit ka pësuar një rënie dhe PAE përbën 58% të stafit të angazhuar në mësimdhënie, kurse PAK, 42% të stafit të angazhuar në këtë program.

(Tabela 3- Aneksi bashkëngjitur)

**Të dhënat sipas seksit**

Konstatohet që raporti sipas seksit për stafin akademik efektiv PAE, i angazhuar në programin e studimit "Master profesional" në "Pedagogji" me profil "Didaktikë" dhe "Menaxhim arsimit", për vitin akademik 2018-2019, është 2 femra dhe 5 meshkuj dhe ai me kontratë PAK është 4 femra dhe 1 mashkull.

**Të dhëna sipas moshës së personelit**

Stafi akademik efektiv PAE, i angazhuar në programin e studimit "Master profesional" në "Pedagogji" me profil "Didaktikë" dhe "Menaxhim arsimit", për vitin akademik 2018-2019, përgjithësisht, ka moshë të re, 5 anëtarë nga 7 i përkasin grupmoshës 25-45 vjeç. Ndërsa stafi akademik me kontratë PAK ka shtrirje të barabartë në të gjithë kategoritë e grupmoshave. (Tabela 5- Aneksi bashkëngjitur)

**Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat**

Konfirmohet që i gjithë stafi akademik efektiv PAE me tituj dhe grada është me kontratë të rregullt me afat të pacaktuar, rregulluar sipas Kodit të Punës dhe Ligjit Nr.80/2015 për Arsimin e Lartë dhe akteve ligjore që rrjedhin prej tij. Ndërsa stafi akademik me kontratë PAK me tituj dhe grada është me kontratë të rregullt me afat të pacaktuar por që rinovohet çdo fillim viti akademik në të cilën përcaktohen lëndet dhe ngarkesa e tij pranë këtij program studimi.

**Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë**

Konstatohet që stafi ndihmës/administrativ nuk është i ngritur në njësi bazë por në nivel njësie kryesore dhe institucionale. Stafi ndihmës i angazhuar për mirëfunksionimin e këtij plan programi rezultoi të jetë me standarte të larta menaxhimi dhe përgjegjshmëri të lartë për realizimin e funksioneve të përcaktuara.

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**


*Lista e pedagogeve të departamentit, të stafit të angazhuar në këtë program studimi dhe ngarkesa mësimore e stafit PAE dhe PAK për vitin akademik 2018-2019, të angazhuar në këtë program studimi .*

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	




<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p><b>Konfirmojmë që:</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen seriozisht për realizimin e objektivave të këtij program studimi.</p> <p><b>Konfirmojmë që:</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen mjaftueshëm për realizimin e strategjisë për zhvillim e institucionit.</p>
<p><b>Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p><b>Konstatojmë që:</b> Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe riorganizimin e kurrikulës.</p> <p><b>Konstatojmë që:</b> Rekrutimi i personelit të ri është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet duke respektuar udhezimin nr.29 dt.10.09.2018 për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik referuar nevojave të departamentit dhe Vendimit Nr. 46, datë 28.09.2018 të Senatit Akademik të AU.</p>
<p><b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p><b>Konstatojmë që:</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit akademik PAE dhe PAK në përputhje me statutin dhe rregulloren e institucionit.</p> <p>Nga te dhenat e dokumentuara nga institucioni rezulton se numri i stafit akademik të brendshëm të angazhuar në kete program studimi ka qënë më i lartë në periudhën 2014-2018, duke ruajtur një raport afër 70 %, ndersa vitin e fundit akademik (2018-2019) ka pësuar një rënie, PAE përbën 58% të stafit të angazhuar në mësimdhënie, kurse PAK, 42% të stafit të angazhuar në këtë program.</p> <p>Kurse në lidhje me ngarkesën mësimore në vitin akademik 2018-2019, PAE mbulon 74.6% kurse PAK, 25.4%.</p> <p><b>Konfirmojmë që:</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit akademik PAE dhe PAK.</p> <p><b>Gjithashtu, konfirmojmë që:</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante të cilat bëhen publike në faqen zyrtare të website: <a href="http://www.alabaninauniversity.edu.al">www.alabaninauniversity.edu.al</a>.</p>
<p><b>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</b></p>	



<p><b>Kriteri 1</b> Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve të mëdha dhe të mëdha akademike në këto universitete;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p><b>Rezultoni se:</b> Pas dhënies të dorëheqjes së përgjegjësit të departamentit me vullnetin e tij të lirë, nga dt. 08.04.2019 në pozicionin e Përgjegjësit të Departamentit të Edukimit dhe të Anglishtes, është emëruar përgjegjës i komanduar, me gradën shkencore Doktor i Shkencave në Univeristetin e Tiranës.</p> <p><b>Konfirmojmë që:</b> Titullarët e lëndëve në programin e studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimi” kanë minimlaisht gradën shkencore “Doktor” dhe një përvojë profesionale mbi 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi.</p> <p><b>Konfirmojmë që:</b> Rektori, zv/rektori, dekani, përgjegjësi i departamentit dhe koordinatori i këtij program studimi janë të punësuar me kohë të plotë në Albanian University;</p> <p><b>Rezultoni se:</b> Institucioni, nëpërmjet koordinorit të programit të studimit në bashkëpunim me DAR Tiranë apo DAR përkatës, mbikëqyr praktikën profesionale të studentëve në profilin “Didaktikë” dhe “Menxhim Arsimit”. Departamenti siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen e temave të masterit profesional.</p>
<p><b>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p><b>Konfirmojmë që:</b> Studentët që ndjekin programin e studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimi” kanë një udhëheqës për hartimin e tezës për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli. Stafit akademik që udhëheq studentët ka minimalisht gradën shkencore “Doktor”.</p> <p><b>Konfirmojmë që:</b> Çdo pedagog i angazhuar në këtë program studimi udhëheq jo më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht.</p>
<p><b>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p><b>Konfirmojmë që:</b> Fusha kërkimore shkencore e udhëheqësve është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit</p> <p><b>Konfirmojmë që:</b> Udhëheqësi ka njohuri për fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>
<p><b>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</b></p>	

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p><b>Konstatohet që:</b> Programi i studimit nuk parashikon orë laboratorike por Institucioni dëshmon një angazhim nga burimet njerëzore për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore në përmbushje të objektivave të programeve në fushat e edukimit. Programet në fjalë, organizohen në seminare/ushtime. Diferenca mes tyre u qartësua përgjatë bashkebisedës me stafin akademik.</p>
<p><b>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p><b>Konstatohet që:</b> Personeli akademik PAE realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në udhëzimin nr.29 dt.10.09.2018 për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik”, ndërsa personeli akademik PAK tejkalon ngarkesën e përcaktuar në këtë udhëzim për stafin e angazhuar me kohë të pjesshme.</p> <p><b>Konfirmohet që:</b> Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik PAE dhe PAK në këtë program studimi vlerësohet me orë mësimore.</p>
<p><b>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p><b>Konfirmohet që:</b> Institucioni ka në dispozicion një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në këtë program studimi për çdo semestër.</p> <p>Institucioni përcakton dhe publikon me rigorozitet kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b></p> <p>Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen mjaftueshëm për realizimin e objektivave të këtij program studim si dhe për hartimin dhe riorganizimin e kurrikulës së këtij program studimi.</p> <p>Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programin e studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimit” përbën 58% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e këtij program studimi. Personeli akademik PAE realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar sipas udhëzimit nr.29 dt.10.09.2018 për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik”, ndërsa personeli akademik PAK tejkalon ngarkesën e përcaktuar në këtë udhëzim për stafin e angazhuar me kohë të pjesshme.</p> <p>Studentët që ndjekin programin e studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimit” kanë një udhëheqës për hartimin e tezës për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli. Stafin akademik që udhëheq studentët ka minimalisht gradën shkencore “Doktor”. Çdo pedagog i angazhuar në këtë program studimi udhëheq jo më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht.</p>	

**4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**



### Pjesa përshkrimore

Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes i zhvillon aktivitetet e procesit mësimor dhe kërkimore shkencore në godinën qendrore të kampusit të Albanian University, e cila ndodhet në Bulevardin "Zogu I". Infrastruktura e universitetit përmban auditore me përmasa të mëdha dhe me kushte të mira fizike.

Të gjitha auditorët janë të pajisura me kompjuter dhe video-projektorë si dhe ekrane, të cilët mundësojnë mësimdhënien me metoda të ndryshme si poëer-point, imazheri etj.

Për ushtrimin e aktiviteteve të tjera ekstrakurrikulare, si simpoziume, konferenca seminare të hapura shkencore, shfaqje filmash etj. është në dispozicion auditori i madh i cili është i pajisur me të gjithë teknologjinë multimediale për realizimin e konferencave, si me qendrën e zërit, qendrën e përkthimit simultan etj.

Biblioteka është e vendosur në një mjedis nëntokë në të cilën mungon drita e diellit. Salla e Bibliotekës disponon një numër tavolinash dhe një kënd leximi. Fondi i bibliotekës pasurohet çdo fillim viti akademik. Aktualisht për programin e studimit "Master profesional" në "Pedagogji" me profil "Didaktikë" dhe "Menaxhim arsimit" në të dyja profilet numëron 30 tituj librash.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

**Mjediset për Programin e studimit**

*Mjediset për Fakultetin të cilat janë përgjegjës për programin e studimit "Master profesional" në "Pedagogji" me profil "Didaktikë" dhe "Menaxhim arsimit": (Tabela 6- Aneksi bashkëngjitur)*

**Mjediset për stafin (Tabela 7- Aneksi bashkëngjitur)**

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

*Numri i studenteve "Master profesional" në "Pedagogji" me profil "Didaktikë" dhe "Menaxhim arsimit" të regjistruar në bibliotekë për vitin akademik 2018-2019.*

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore; <b>Kriteri 2</b> Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet; <b>Kriteri 3</b> Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron; <b>Kriteri 4</b> Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë,	<b>Konfirmojmë që:</b> Institucioni ka vendndodhje të përhershme ku zhvillohet veprimtaria mësimore. Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për më shumë se 6 vjet. <b>Konfirmojmë që:</b> Programi i studimit "Master profesional" në "Pedagogji" me profil "Didaktikë" dhe "Menaxhim arsimit" ofrohet brenda godinës qendrore të institucionit. Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e programit. Por praktikant profesional nuk përmbushen në mjediset e institucionit por në institucionet shkollore me të cilat janë të kontraktuar studentët.

shkencave teknike, etj.

#### Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.

**Kriteri 1** Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;

**Kriteri 2** Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;

**Kriteri 3** Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;

**Kriteri 4** Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zëra ve të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;

**Kriteri 5** Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.

**Konstatohet që:** Titujt e literaturës në funksion të studentëve të programit të studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimit” me dy profile për realizimin e projekteve kërkimore dhe realizimit të tezës së diplomës janë të pamjaftueshëm.

Në bibliotekë **rezulton se** vetëm 23 studentë të profilit Didaktikë kanë hapur kartelë për marrjen e librave dhe 10 në Menaxhim Arsimit nga 191 studentë që janë të regjistruar këtë vit në “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimit”.

**Konstatohet që:** Libraria elektronike “QUESTIA” përmban tituj librash dhe revista shkencore të konsiderueshme për realizimin me sukses të këtij program studimi, të realizimit të projekteve kërkimore shkencore dhe për përgatitjen e tezës së diplomës. Biblioteka dhe institucioni nuk mund të nxjerrë të dhëna të sakta për numrin e studentëve të cilët aksesojnë në librarinë elektronike.

**Konfirmohet që:** Përgjegjësit e programit kanë hartuar një fond titujsh në fillim të vitit akademik, i cili shton pjesërisht numrin e zërave të titujve në bibliotekë në mbështetje të programit të studimit.

**Konfirmohet që:** Biblioteka ka orar të plotë shërbimi 08.00-16.00.

#### Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

**Kriteri 1** Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

**Kriteri 2** Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

**Kriteri 3** Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;

**Kriteri 4** Institucioni, në varësi të programeve të

**Gjatë vizitës në institucion dëshmojmë që:** Institucioni ka laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit për realizimin e mësimdhënies të këtij program studimi.

**Konfirmohet që:** Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit të studimit në fjalë.

studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Institucioni ka vendndodhje të përhershme ku zhvillohet veprimtaria mësimore e programit të studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimi”. Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për këtë program studimi.

Titujt e literaturës në funksion të studentëve të programit të studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimi” për realizimin e projekteve kërkimore dhe realizimit të tezës së diplomës janë të reduktuar.

Egziston një fond titujt i planifikuar për këtë program studimi i cili është pjesërisht në mbështetje të programit të studimit në fjalë.

Në bibliotekë janë të regjistruar vetëm 23 studentë të profilit Didaktikë dhe 10 në Menaxhim Arsimi nga 192 studentë që janë të regjistruar këtë viti në “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimi”.

Libraria elektronike “QUESTIA” përmban tituj librash dhe revista shkencore të konsiderueshme për realizimin me sukses të këtij program studimi, në shërbim të realizimit të projekteve kërkimore shkencore dhe për përgatitjen e tezës së diplomës, por nuk kemi mjaftueshëm informacion se në çfarë mase studentët kanë akses, pasi nuk ka instrumente për të matur këtë raport të studentit me librarinë elektronike. Gjithsesi institucioni e ofron.

**5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare**

**Pjesa përshkrimore**

Burimet financiare të programit të studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimi” janë kryesisht nga tarifat e shkollimit, të cilat shkojnë për rritjen e kapacitetit dhe përmirësimin e strukturave menaxhuese. Me menaxhimin e këtij buxheti, merret Zyra për Menaxhimin e Burimeve Financiare e cila është ngritur në rang univeritati. Reth 1/3 e burimeve financiare të ardhura nga tarifat e studentëve shkon për qiranë e objektit dhe shërbime të tjera të lidhura me përmirësimin e infrastrukturës fizike dhe kushteve higjeno-sanitare. Pjesa tjetër e të ardhurave shpenzohet për pagesën dhe sigurimet shoqërore të stafit akademik PAE dhe PAK, të angazhuar në këtë program studimi. Në lidhje me grantet kërkimore shkencore dhe shërbimet trajnuese nuk ka buxhet në dispozicion.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

(Tabela 8- Aneksi bashkëngjitur)

**Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)**

*Kostoja per student në programin e studimit "Master profesional" në "Pedagogji" me profil "Didaktikë" dhe "Menaxhim arsimi" me Profil në "Didaktikë" dhe "Menaxhm Arsimi" është 500 euro (65000 ALL)/ për vit akademik.*

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

*Institucioni nuk ka vënë në dispozicion ndonjë dokumentacion specifik në lidhje me menaxhim e burimeve finnaciare. Të ardhurat dhe financimet ne këtë institucion regjistrohen dhe auditohen mbi bazën e NIPT të lëshuar nga QKR.*

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë; <b>Kriteri 2</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë; <b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.	<b>Rezulton që:</b> Raporti i auditit bëhet në nivel institucioni, i përvitshëm nga një kontabël i miratuar. Si rrjedhojë nuk ka një raport auditimi për programin e studimit "Master profesional" në "Pedagogji" me profil "Didaktikë" dhe "Menaxhim arsimi". <b>Rezulton se:</b> Institucioni nuk përfiton asnjë grant të huaj që mund të derivojnë nga kontratat e shërbimeve. <b>Rezulton se:</b> Në raportin financiar të auditit analizohet eficientia e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në këtë program studimi.
<b>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj. <b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.	<b>Rezulton se:</b> Institucioni harton një raport në rang universiteti e si rrjedhojë nuk ka një raport me të dhëna të hollësishme financiare për realizimin e programit të studimit të Masterit Profesional. <b>Rezulton se:</b> Institucioni ka qëndrueshmëri financiare përgjatë zhvillimit të këtij program studimi dhe kapacitete financiare për të siguruar qëndrueshmëri dhe cilësi programit të studimit "Master profesional" në "Pedagogji" me profil "Didaktikë" dhe "Menaxhim arsimi".
<b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b>	
Burimet financiare të programit të studimit "Master profesional" në "Pedagogji" me profil "Didaktikë" dhe "Menaxhim arsimi" janë kryesisht nga tarifat e shkollimit. Raporti i auditit financiar bëhet në nivel institucioni e si rrjedhojë nuk ka një raport me të dhëna të hollësishme financiare për realizimin e programit të studimit të Masterit Profesional. Është për t'u vlerësuar që institucioni ka qëndrueshmëri financiare përgjatë zhvillimit dhe kapacitete financiare për ti siguruar qëndrueshmëri dhe cilësi programit të studimit "Master profesional" në "Pedagogji" me profil "Didaktikë" dhe "Menaxhim arsimi". Nuk konstatoam të ketë qoftë dhe një buxhet modest për grantet kërkimore shkencore dhe shërbimet	

## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

### Pjesa përshkrimore

Njësia e SBC, në Albanian University, është krijuar si zyrë në fillim të vitit akademik 2009-2010. Me hyrjen në fuqi të Ligjit 80/2015 Për Arsimin e Lartë është ngitur me vendim të Senatit Akademik (Nr.4, dt.22/12/2016) Komisioni i Përhershëm për Vlerësimin Institucional.

NjsBC ushtron funksion mbështetës, monitorues, vlerësues si dhe ofron ekspertizë për zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë. Gjithashtu NjsBC ka funksion të hartojë politikat e vetëvlerësimit dhe të përcaktojë kriteret e vlerësimit, të cilat realizohen nëpërmjet anketimeve dhe raporteve vlerësuese.

Që prej vitit 2016, NjsBC, në bashkëpunim me departamentet funksionon, ngirhet një komisionin Ad-hoc, në nivel njësie bazë, për të vlerësuar programet mësimore, literaturën, format e vlerësimit.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

#### Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

- Sa anketime kanë bërë me studentët

*Për programin e studimit "Master profesional" në "Pedagogji" me profil "Didaktikë" dhe "Menaxhim arsimit", kryen dy anketime në vit, në fund të çdo semestri.*

- Sa studentë janë anketuar

*Gjatë vitit akademik 2018-2019, për programin e studimit "Master profesional" në "Pedagogji" me profil "Didaktikë" dhe "Menaxhim arsimit", janë realizuar fokus grupe, ku kanë marrë pjesë 50.5%.*

- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë

*Për programin e studimit "Master profesional" në "Pedagogji" me profil "Didaktikë" dhe "Menaxhim arsimit", vlerësimet janë përgjithësisht pozitive, nuk kanë paraqitur problematika specifike në lidhje me programin e studimit në fjalë.*

- Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm

*Rezultatet e anketimeve përpunohen dhe dërgohen në njësinë bazë në të cilën ofrohet programi i studimit në mënyrë që të merren masat për zgjidhjen e problematikave që mund të parashtrijnë studentët në lidhje me lëndët, literaturën, lektorët etj.*

#### Kontrolli i brendshëm i cilësisë



Kontrolli i brendshëm i cilësisë së programeve të studimit realizohet në mënyrë periodike në fund të çdo semestri, nëpërmjet anketimeve, fokus-grupeve dhe vetëvlerësimit që realizojnë pedagoget.

**Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti**

*Që prej vitit 2016, NjSBC, në bashkëpunim me departamentet funksionon në nivel njësie bazë, duke ngritur grupe pune ad-hoc për Sigurimin e Cilësisë, për të vlerësuar programet mësimore, kurrikulën, syllabuset, format e vlerësimit.*

**Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre**

*Departamenti, çdo vit akademik, harton raportin semestral dhe vjetor të vetëvlerësimit, në të cilin pasqyrohen të dhënat e stafit akademik dhe rekrutimet, literatura e përdorur, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore-shkencore.*

**Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike**

*Relative, pasi nuk janë shfaqur problematika specifika në lidhje me programet e studimit dhe procesin e mësimdhënies.*

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

*Buletini vjetor mbi analizën e të dhënave të anketimit të realizuar me studentët në nivel institucioni.*

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;</li> <li>Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</li> <li>Pyetje konceptuale;</li> <li>Intervista;</li> <li>Etj.</li> </ol> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në teste të</li> </ol>	<p><b>Konstatojmë që:</b> Institucioni nëpërmjet NjSBC kryen raporte vlerësimi periodik semestral dhe publikon nëpërmjet buletinëve vjetor rezultatet e anketimeve.</p> <p><b>Konstatojmë që:</b> Institucioni aplikon metoda të ndryshme vlerësimi të tërthorta nëpërmjet sondazheve të studentëve, sondazheve të vlerësimit të mësimdhënies, realizimit të intervistave me fokus-grupe dhe të drejtpërdrejta si dëgjimi në auditor, vlerësimi i rezultateve të arritura nga studentet, vëzhgime gjatë procesit të realizimit të projekteve dhe praktikës profesionale.</p>

<p>standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);</p> <p>b. Dëgjime në auditor;</p> <p>c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</p> <p>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</p> <p>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	
<p><b>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p><b>Konstatohet që:</b> Institucioni ka publikuar për vitin akademik 2018-2019 raportin vjetor, në të cilin pasqyrohet analiza e të dhënave të sondazhit të kryer me studentet.</p>
<p><b>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecures së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p><b>Konstatohet që:</b> Njësia bazë harton analiza semestrale dhe vjetore për vlerësimin e ecures së programit të studimit master profesional, analizë e cila pasqyrohet në raportin vjetor të institucionit.</p> <p><b>Konstatohet që:</b> Institucioni ka ndërmarrë politika përmirësuese për zhvillimin e programit të studimit "Master profesional" në "Pedagogji" me profil "Didaktikë" dhe "Menaxhim arsimit" nga viti 2013, akreditimi i parë.</p>
<p><b>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p><b>Konstatohet që:</b> Albanian University është akredituar në nivel institucional nga Bordi i akreditimit nr.90, dt.20/10/2017, me kohëzgjatje 2 vjeçare.</p> <p><b>Konstatohet që:</b> Institucioni ndjek procedura korrekte për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre dhe aplikon mekanizmat formalë për miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit "Master profesional" në "Pedagogji" me profil "Didaktikë" dhe "Menaxhim arsimit".</p> <p><b>Konfirmohet që:</b> Institucioni synon të përcojë vlerat dhe rëndësinë që ka një program studimi "Master profesional" në "Pedagogji" me profil "Didaktikë" dhe "Menaxhim arsimit" tek studentët.</p>

### **Konkluzionet e vlerësimit:**

Institucioni nëpërmjet NjSBC kryen raporte vlerësimi periodik vjetor. Institucioni aplikon metoda të ndryshme vlerësimi të tërthorta nëpërmjet sondazheve të studentëve, sondazheve të vlerësimit të mësimdhënies, realizimit të intervistave me fokus-grupe dhe të drejtëpërdrejta si dëgjimi në auditor, vlerësimi i rezultateve të arritura nga studentët, vëzhgime gjatë procesit të realizimit të projekteve dhe praktikës profesionale. NjSBC, sekretaria dhe stafi mbështetës kryejnë punë serioze dhe në respekt të parimeve etike.

Institucioni prirret të përditësojë programin e studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimit” nga viti 2013, akreditimi i parë, por ende nuk është arritur nga ana e Institucionit krijimi i “standardeve” që listojnë kompetencat e studentit që diplomohet në “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë”.

## **POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE**

### **7. Programi i studimit, organizimi i tij**

#### **Pjesa përshkrimore**

Programin e studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimit” është hapur me VKM Nr. 89, datë 10.02.2010 (Master i Nivelit të Parë, MNP) me kohëzgjatje 1 vit akademik, 60 ECTS. Programi është riorganizuar nga MNP në MP me Vendim Senati Nr. Prot. 192, datë 25.01.2011, 90 ECTS për të dyja profilet e studimit. Programi është akredituar për herë të parë me Urdhër Nr. 29, datë 31.01.2013, MASH. Në shkurt të vitit 2018 ky program studimi është riorganizuar përsëri me kohëzgjatje 1 vjeçare me 60 ECTS.

Ky program studimi funksionon në bazë të rregullores së tij, në të cilën përcaktohen qartë objektivat e programit të studimit, struktura e programit të studimit për secilin profil, format e vlerësimit dhe të drejtat e studentit. Plan programi i studimit është hartuar konform VKM Nrr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, i ndarë në kredite dhe disiplina karakterizuese përkatëse. Kreditet janë të ndara në leksione, seminare, ushtrime në auditor dhe punë e pavarur e studentëve

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

##### **Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi**

Programi i studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimit” ka nisur aktiviteti e tij akademik në vitin 2010.

Qëllimi i këtij programi studimi me profil në “Didaktikë” është të formojë mësues të sistemit arsimor parauniversitar, në të gjitha ciklet e studimit dhe “Menaxhim arsimit” ka si qëllim të formojë ekspert dhe menaxherë edukimi në sistemin arsimor parauniversitar.

##### **Organizimi i programit të studimit (1 vit akademik, 2 semestra, 30 javë etj.)**

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor

- Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë.**

*Progami i studimit "Master profesional" në "Pedagogji" me profil "Didaktikë" dhe "Menaxhim arsimit" ka 60 ECTS, 30 ECTS në semester, lëndët që ofrohen të kategorisë A dhe B kanë 5 ECTS = 2 ECTS Leskione, 2 ECTS Seminare dhe 1 ECTS Ushtrime.*

- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:**

▪ Për leksionet	11.5 orë në auditor dhe 14.5 orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Seminaret	15 orë në auditor dhe 17.5 orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Labororet	15 orë në auditor dhe 10 orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Praktikat lëndore	2 orë në auditor dhe 23 orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Praktikën Profesionale	20 orë në auditor dhe 23 orë punë e pavarur e studentit
▪ Provimi përfundimtar	12 orë në auditor dhe 23 orë punë e pavarur e studentit

- Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara**

Progami i studimit "Master profesional" në "Pedagogji" me profil "Didaktikë" dhe "Menaxhim arsimit" me Vendim Senati nr.6 dt.28.02.2018 ka ndryshuar plan programin e tij, nga 90 ECTS në 60 ECTS.

**( Tabela 12 ne Aneks)**

Ndryshimet e konstatuara ndahen në disa kategori:

➤ *Ndryshim kreditesh të lëndëve:*

Psikologji Edukimi 6 ECTS behet 5 ECTS ,

Legjislacioni dhe reforma në sistemin parauniversitar 6 ECTS bëhet 5 ECTS,

Pedagogji e përgjithshme 6 ECTS bëhet 5 ECTS,

Metodologji e përgjithshme 7 ECTS bëhet 5 ECTS,

Hartim dhe zhvillim i kurrikulës në sistemin parauniversitar 6 ECTS bëhet 5 ECTS,

Lëndë me zgjedhje 4 ECTS bëhet 5 ECTS,

Inspektimi dhe supervizimi në arsim 7 ECTS bëhet 5 ECTS (MA).

➤ *Ndryshim terminologjie dhe kreditesh*

Vlerësimi i shkollës dhe mësimnxënies 6 ECTS bëhet Vlerësimi dhe standartet në edukim 5 ECTS

Praktika dhe filozofia e drejtimit të shkollës 7 ECTS bëhet bazat e drejtimit dhe administrimit në arsim 5 (MA)

Lëndë me zgjedhje (Identiteti shqiptar dhe edukimi/Edukimi në vende të ndryshme) 4 ECTS bëhet Shkolla dhe komuniteti/Metodat e kerkimit shkecor) 5 ECTS

➤ *Heqje kursi nga kurrikula*

Menaxhim klase 7 ECTS (DID)

Teoritë dhe ideologjitë e edukimit 6 ECTS (MA)

➤ *Shtohen lënde të reja*

Shkrimi akademik 5 ECTS (DID dhe MA)

Lëndë me zgjedhje (Histori e arsimit dhe Edukimi në vende të ndryshme të EU) 3ECTS

Lëndë me zgjedhje (Politika arsimore dhe Edukimi në vende të ndryshme të EU) 3ECTS

Konstatohet që kurset e veprimtarisë formuese B në të dyja profilet tejkalojnë % specifike të tyre, 41%.

Gjithashtu konstatohet se pavarësisht qëllimit dhe objektivave të formimit të ndryshëm që kanë profilet që ofrohen në këtë program studimi, lëndët e veprimtarisë formuese kategorija B, janë të njëjta.

- Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

(Tabela 13 ne Aneks)

- Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Syllabuset janë hartuar sipas standarteve të percaktuara në VKM nr. 41, datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL". Në çdo syllabus janë të percaktuara qartë: Emërtimi i lëndës, Viti/semestri kur zhvillohet lënda, Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën, Kategorija e veprimtarisë formuese, Njohuritë dhe Aftësitë që duhet të marrë studenti, Shpërndarja e ngarkesës, Format e vlerësimit dhe mësimdhënies).

- Analizë e cilësisë së syllabuseve

Tekstet e përdorura në çdo syllabus i ofrohet studentit në gjuhë shqipe. Konstatohet që literatura e detyruar dhe ndihmëse është e percaktuar qartë por nuk është e viteve të fundit.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Nuk është marrë asnjë dokumentacion shtesë.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS); <b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	<b>Konfirmojmë që:</b> Programi i studimit "Master profesional" në "Pedagogji" me profil "Didaktikë" dhe "Menaxhim arsimi" është licensuar me VKM Nr. 89, datë 10.02.2010 (Master i Nivelit të Parë, MNP) me kohëzgjatje 1 vit akademik, 60 kredite dhe është akredituar për herë të parë me Urdhër MASH Nr. 29 datë 31.01.2013. <b>Konfirmojmë që:</b> Ky program studimi është me kohëzgjatje 1 vit akademik, organizuar në dy semestre, dhe studenti përfiton 60 ECTS
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave", "Master i arteve të bukura" apo "Master Profesional" i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare "Bachelor" me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional; <b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve "Master i	<b>Rezulton se:</b> Programi i studimit "Master profesional" në "Pedagogji" me profil "Didaktikë" dhe "Menaxhim arsimi" i adresohet të gjithë të diplomuarve me të cilën zotërojnë një diplomë bachelor me synimin për t'i pasjitur me njohuri teorike dhe praktike rreth modeleve dhe metodave të mësimdhënies si dhe lidërshiptit shkollor.  <i>Rezulton se: Në momentin e licensimit dhe akreditimit të parë të "Master profesional" në "Pedagogji" profili</i>

<p>Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 7</b> Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>“Didaktikë”, misioni dhe objektivat per kualifikimin e mësimeve në cikle të ndryshme të sistemit parauniversitar ishin të specifikuar qartë, por me hyrjen në fuqi të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 dhe me Ligjit nr. 48/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar” programi i studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë”, nuk specifikon qartë ciklin dhe disiplinën në të cilin do të zhvillojë mësime studentit i diplomuar.</p> <p>Ndërsa për Programin e studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Menaxhim arsimit”, me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 48/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, për sistemin arsimor parauniversitar”, zhvillimi profesional dhe trajnimi e certifikimi i drejtuesëve dhe administratorëve të shkollës do të realizohet nëpërmjet Shkollës së Drejtorëve.</p>
<p><b>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshatje me nivelin e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p><b>Konfirmojmë që:</b> Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimit “Master profesional” në “Pedagogji”, me dy profile përgjithësisht është në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohet.</p> <p><b>Rezultoni se:</b> Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm, projekteve të realizuara dhe provimit përfundimtar janë përgjithësisht në përputhje me ciklin e studimit në fjalë.</p>
<p><b>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensionet ndërkombëtare.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve mbështeten në përvojën disave evropiane dhe praktikatat e mira të vendeve evropiane;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomatat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislativon dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p><b>Rezultoni se:</b> Programi i studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimit” në bashkëpunim PAE dhe PAK të kualifikuar në vende evropiane perëndimore kanë përcjellë dhe implementuar praktikatat e këtyre vendeve për hartimin e kurrikulës dhe metodave të mësimit dhe vlerësimit.</p>
<p><b>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë</p>	<p><b>Konstatojmë se:</b> Programi i studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me dy profile, është hartuar</p>

<p>përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>në përputhje me strategjinë për zhvillim e institucionit.</p> <p>Lëndët karakterizuese në të dyja profilet e studimit rezultojnë të jenë të njëjta. Ky program studimi ka nevojë për rishikim dhe përmirësim të kategorisë së lëndëve karakterizuese të cilat duhet të jenë në shërbim të formimit profesional të dy profileve të cilët kanë specifika të ndryshme aftësimi profesional.</p> <p><b>Konstatohet se:</b> Stafit akademik është i angazhuar në punën kërkimore për realizimin e këtij program studimi.</p>
<p><b>Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p><b>Konstatohet se:</b> Institucioni ka realizuar një studim tregu analitik por pa u thelluar në një studim empirik mbi nevojat dhe domosdoshmërinë që ka tregu i punës, sot, i diktuar nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>
<p><b>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar a ndërkombëtar;</li> <li>b. kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</li> <li>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</li> </ol>	<p><b>Konstatohet që:</b> Për këtë vit akademik numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi është relativisht i madh. Pjesa më e madhe prej tyre janë në marrëdhënie pune.</p> <p><b>Konfirmohet që:</b> Institucioni ka kryer një vlerësim të tregut në të cilin përfshihet numri i të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</p>
<p><b>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p><b>Konfirmohet që:</b> Programi i studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me dy profile, nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe ruan vlerat kulturore kombëtare.</p>
<p><b>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p><b>Konfirmohet që:</b> Programi i studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimi” ka kohëzgjatje normale 1 vit akademik. Në përfundim të këtij cikli studimi, studentët përfiton 60 ECTS.</p>

<p><b>Kriteri 3</b> Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	
<p><b>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët; <b>Kriteri 2</b> Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p><b>Konfirmojmë që:</b> Studentët janë të pasjitur me informacion rreth kurseve dhe syllabusve që ky program studimi ofron. Gjatë javës orientuese në fillim të vitit akademik studentët informohen mbi programet e studimit, modulet dhe syllabuset që institucioni ofron në forma të shkruara dhe elektronike.</p>
<p><b>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar; <b>Kriteri 2</b> Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p><b>Konfirmojmë që:</b> Në planin e programit të studimit master profesional pasqyrohet qartë mënyra e diplomimit dhe afati i përfundimit të studimit.</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b></p> <p>Programi i studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me dy profile i adresohet të gjithë të diplomuarve të cilën zotërojnë një diplomë bachelor me synimin për t’i pasjitur me njohuri teorike dhe praktike rreth modeleve dhe metodave të mësimdhënies si dhe lidhshimit shkollor.</p> <p>Konstatohet se institucioni ka realizuar një studim tregu analitik, por pa u thelluar në një studim empirik mbi nevojat dhe domosdoshmërinë që ka tregu i punës, sot, i diktuar nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p><i>Rezultoni se: Në momentin e licensimit dhe akreditimit të parë të “Masterit profesional” në “Pedagogji” profili “Didaktikë”, misioni dhe objektivat për kualifikimin e mësimdhënësve në cikle të ndryshme të sistemit parauniversitar ishin të specifikuar qartë, por me hyrjen në fuqi të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 dhe me Ligjin nr. 48/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar” programi i studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë”, nuk specifikon qartë ciklin dhe disiplinën në të cilin do të zhvillojë mësimdhënie studenti i diplomuar.</i></p> <p>Ndërsa për Programin e studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Menaxhim arsimit”, me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 48/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, për sistemin arsimor parauniversitar”, zhvillimi profesional dhe trajnimi e certifikimi i drejtuesëve dhe administratorëve të shkollës do të realizohet nëpërmjet Shkollës së Drejtorëve.</p>	

## 8. Mësimdhënia

### Pjesa përshkrimore

Format kryesore të procesit mësimor në programin e studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimit” janë leksionet, seminarët dhe ushtrimet. Procesi i mësimdhënies shkon në interes të zhvillimit profesional të studentëve dhe respektimit të përvojës individuale të tyre nëpërmjet realizimit të projekteve individuale në çdo lëndë. Pedagogët përdorin teknologjinë për realizimin e procesit mësimor dhe përiçen të krijojnë një mjedis motivues për t’i mbështetur studentët në aritjet e tyre akademike.



### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

**Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet**

Format për realizimin e procesit të mësimdhënies në programin e studimit "Master profesional" në "Pedagogji" me profil "Didaktikë" dhe "Menaxhim arsimit" kanë leksione, seminare, ushtrime, projekte lëndore, teste, provim dhe praktikë profesionale. (Tabela ... e Planit ne aneks):

**Format e kontrollit të njohurive**

Kontrolli i njohurive në këtë program studimi bëhet me detyrat e kursit, me shkrim, me dosje për realizimin e praktikës profesionale dhe me komision për mbrojtjen e tezës së diplomës.

**Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj**

Konstatojmë që studentët janë pjesë e komisionive të ndryshme të ngritura në nivel departamenti dhe në punimet individuale shkencore të pedagogëve. Në hartimin e RVB për këtë program studimi, një nga katër anëtarët e grupit të punës është studente aktuale e "Master profesional" në "Pedagogji" me profil "Didaktikë" dhe "Menaxhim arsimit".

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Dosjet individuale të studentëve që dëshmojnë zhvillimin e praktikës profesionale. Projekte kërkimore të realizuara nga studentët.

## 9. Studentët


### Pjesa përshkrimore

Të drejtën për të aplikuar në këtë program studimi e kanë kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet universitare "Bachelor" në fushën përkatëse, në Shqipëri ose jashtë saj (ekuivalente sipas kriterëve të vendosura nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës). Procedura dhe Kriteret e pranimit të studentëve zhvillohen konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Koha e zgjatjes së studimeve është kryesisht vit akademik. Nota mesatare në hyrje është afërsisht 7.5 për të dyja profilet [Evidenc: Numri i studentëve, cilësia në hyrje dhe në dalje, 2010-2018].

Numri i të regjistruarëve për vitin akademik 2018-2019, për profilin "Didaktikë" është 149, ndër të cilët 148 të regjistruar për herë të parë dhe 1 transferim studimesh dhe profili "Menaxhim Arsimit" 42 nga të cilët 25 për herë të parë dhe 17 transferim studimesh nga Shkolla e Lartë "Justicia" sipas Udhëzimit nr.26, dt.30.07.2018 të MARS.

### Vlerësimi i Tregues të matshëm:

**Procedurat e pranimit të studentëve**



*Procedurat që ndiqen për pranimin e studentëve në programin master profesional në pedagogji janë konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe politikave të institucionit. Pranimi i kandidatëve kryhet nëpërmjet shqyrtimit të dosjeve që kandidatët dorëzojnë pranë sekretarive. Për pranimin e studentëve të transferuar ngrihet një komision ad-hoc nga departamenti për shqyrtimin e dosjeve të studentëve.*

**Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve**

*Studentet e regjistruar në këtë program studimi, për vitin akademik 2018-2018, janë mbi mesataren e vendosur nga MARS për studentët të cilët duhet të ndjekin programet e studimit në fakultet e edukimit.*

**Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare**

*Studentët e regjistruar për herë të parë në vit të parë, për vitin akademik 2013-2014, pas akreditimit të parë, ka qënë 7.02. (Tabela 17 e Planit ne aneks):*

**Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare**

*Nota mesatare e studentëve të diplomuar, në vitin akademik 2017-2018, për profilin Didaktikë është 8 dhe Menaxhim Arsimi 8.3.*

**Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend**

*Për vitin akademik 2018-2019, në profilin Menaxhim Arsimi 17 studentë janë transferuar nga Shkolla e Lartë "Justicia"*

**Të dhëna për punësimin e studentëve**

*Për vitin 2019 rezulton se për profilin "Didaktikë" 102 studentë janë të punësuar në përputhje me diplomën dhe dhe 47 jo në përputhje me diplomën, ndërsa në profilin Menaxhim Arsimi 9 studentë janë të punësuar në përputhje me diplomën dhe 3 jo në përputhje me diplomën.*

**Numri total të diplomuarve**

*Rezulton se numri total i të diplomuarve, pas akreditimit të parë, nga viti 2013 për profilin "Didaktikë" janë 615, ndërsa në profilin "Menaxhim Arsimi" 152.*

**Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)**

*Numri total i të punësuarve në përputhje me diplomën, për profilin Didaktikë janë 410, ndërsa në profilin Menaxhim Arsimi 100.*

**Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)**

*Numri total i të punësuarve në përputhje me diplomën, per profilin Didaktike janë 205, ndërsa në profilin Menaxhim Arsimi 52.*

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**




Të dhenat statistikore nga sekretaria mësimore mbi mesataren dalëse të studentëve të programit të studimit në fjalë, ndër vite.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p><b>Konfirmojmë që:</b> Të gjithë studentët e regjistruar në programin e studimit “Master professional” në “Pedagogji” me dy profile zotërojnë diplomën universitare “Bachelor”.</p> <p><b>Konfirmojmë që:</b> Procedurat dhe kriteret e pranimit janë konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në përputhje me politikat e hartuara nga institucioni. Të gjithë studentët e regjistruar për herë të parë por edhe ato të transferuar janë të pajisur me numër matrikulli.</p>
<b>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p><b>Konstatojmë që:</b> Përgjithësisht studentët e regjistruar në këtë program studimi janë në marrëdhënie pune.</p> <p><b>Konstatojmë</b> nga takimi me studentët se janë të mirëinformuar rreth akreditimit të programit dhe vlefshmërisë së programit që ndjekin.</p> <p><b>Konstatojmë që:</b> Studentët orientoohen për zhvillimin e karrierës.</p>
<b>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë</p>	<p><b>Dëshmojmë që:</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, për numrin e studentëve të regjistruar, për tërheqjet dhe largimet para përfundimit ketij program studimi në të dyja proflet e tij.</p>

akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.	
<b>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikën e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p><b>Konfirmojmë se:</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programit të studimit “Master professional” në “Pedagogji” me dy profile.</p>
<b>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p><b>Konstatohet që:</b> Studentët janë të mirë informuar për programin e studimit që frekuentojnë, për statusin e akreditimit të programit si dhe janë të informuar për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit.</p>
<b>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p><b>Konstatohet se:</b> Nëpërmjet Zyrës së koordimit dhe mbështetjes, institucioni është përgjegjës për krijimin e politikave mbështetëse që lidhen me zhvillimin e procesit mësimor. Gjithashtu nëpërmjet zbatimit të programit të mentorshipit studentët realizojnë praktikën e tyre profesionale në shkollat e sistemit parauniversitar.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p>Procedurat që ndiqen për pranimin e studentëve në programin e studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me dy profile janë konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe politikave të institucionit. Pranimi i kandidatëve realizohet nëpërmjet shqyrtimit të dosjeve që kandidatët dorëzojnë pranë sekretarive. Për pranimin e studentëve të transferuar ngrihet një komisionin ad-hoc nga departamenti për shqyrtimin e dosjeve të studentëve.</p> <p>Numri i të regjistruarve për vitin akademik 2018-2019, për profilin Didaktikë është 149, ndër të cilët 148 të regjistruar për herë të parë dhe 1 transferim studimesh dhe profili Menaxhim Arsimit 42 nga të cilët 25 për herë të parë dhe 17 transferim studimesh nga Shkolla e Lartë “Justicia” sipas Udhëzimit Nr.26, dt.30.07.2018 të MARS. Nota mesatare në hyrje është afërsisht 7.5 për të dyja profilet dhe ajo dalëse, për vitin akademik 2017-2018 është afërsisht 8.2 për të dy profilet.</p> <p>Dëshmojmë që institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, për numrin e studentëve të regjistruar, për tërheqjet dhe largimet para përfundimit të këtij program studimi në të dy profilet e tij. Përgjithësisht studentët e regjistruar në këtë program studimi janë në marrëdhënie pune.</p>	

## KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

### 10. Kërkimi shkencor

#### Pjesa përshkrimore

AU në politikat e tij ka si qëllim zhvillimin e kërkimit shkencor në funksion të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe si rrjedhojë rritjen e cilësisë së programit të studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimit”. Stafit akademik i Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes është angazhuar në kërkimin shkencor në disiplinat përkatëse të formimit duke marrë pjesë në Konferencat Kombëtare dhe Ndërkombëtare të organizuara nga institucioni dhe botime në revistën shkencore periodike “Optime” të institucionit.

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

**Të dhëna për kërkimin shkencor**

Numri i botimeve individuale të kërkimit shkencor nga stafi akademik i Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes për tre vitet e fundit (2016-2019), është 50. (Tabela 19 ne aneks)

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse; <b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	<b>Konfirmojmë që:</b> Stafit akademik i Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes është mjaftueshëm i angazhuar në kërkimin shkencor në disiplinat përkatëse të formimit. Stafi i këtij departamenti publikon rregullisht në revistën shkencore “Optime” të institucionit. Do të shfaqte interes, për zhvillimin e kërkimit shkencor, botimi i një reviste shkencore periodike me ISSN ku të fokusohen në shkencat e edukimit dhe didaktikë.
<b>Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj; <b>Kriteri 2</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.	<b>Konstatojmë që:</b> UA nuk ofron programe studimi në gjuhë të huaj por stafi akademik zotëron mjaftueshëm njohje të gjuhëve të huaja.
<b>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</b>	

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p><b>Konfirmojmë që:</b> Institucioni nëpërmjet programit të Erasmus + i ofron mundësi stafit akademik për kulifikim profesional dhe mbështetje financiare në aktivite të ndryshme shkencore ndërkombëtare.</p>
<p><b>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p><b>Rezulton se:</b> Institucioni disponon një raport individual të stafit akademik për aktivitetet dhe botimet shkecore por, nuk na është vënë në dispozicion asnjë dokument që të dëshmojë se egziston një bazë të dhënash.</p> <p><b>Konfirmojmë se:</b> Institucioni nuk ka marrë pjesë në asnjë projekt shkencor.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p>Stafi akademik i Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes është i angazhuar në kerkimin shkencor në disiplinat përkatëse të formimit.</p> <p>Institucioni nëpërmjet programit të Erasmus + i ofron mundësi stafit akademik për kulifikim profesional dhe mbështetje financiare në aktivite të ndryshme shkencore ndërkombëtare.</p> <p>Institucioni disponon një raport individual të stafit akademik për aktivitetet dhe botimet shkecore por nuk na është vënë në dispozicion asnjë dokument që të dëshmojë se egziston një bazë të dhënash. Konfirmojmë se institucioni nuk ka marrë pjesë në asnjë projekt shkencor.</p>	

**11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun**


**Pjesa përshkrimore**

Në politikat e tij për zhvillim dhe përmirësim, AU, ka prioritet marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare. AU ka nënshkruar marrëveshje institucionale me disa prej IAL publike si dhe Drejtoritë Arsimore si dhe intitucione për organizimin e konferencave, trajtimeve dhe zhvillimin e praktikës profesionale të studentëve të programit të studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimit”.

Intitucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dypalëshe edhe me institucione ndërkombetare si Univeristetin Sigmund Freud, Vjenë, Universitetin e Padovës, Aquilas etj.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar**

AU ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dypalëshe edhe me institucione ndërkombetare si Univeristetin Sigmund Freud, Vjenë, Universitetin e Padovës, Aquilas. (Tabela 21 ne aneks)

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë .**

Institucioni ka nënshkruar marrëveshje institucionale me disa prej IAL publike si dhe Drejtoritë Arsimore si dhe intitucione për organizimin e konferencave, trajtimeve dhe zhvillimin e praktikës profesionale të studentëve të programit të studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimit”.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Akt marrëveshje me DAR Tiranë dhe institucione të tjera shtetërore.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimim e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p><b>Konfirmojmë që:</b> Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë Arsimore Tiranë dhe Durrës për kryerjen e praktikës profesionale në profilin Didaktikë dhe Menaxhim Arsimit. Por, në marrëveshje mungojnë zëra konkretë që rregullojnë sistemin e mentorimit në shkollat ku përmbushet praktika profesionale.</p>
<b>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p><b>Konstatojmë që:</b> Institucioni krijon klimë bashkëpunuese brenda institucionit për marrjen e përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>
<b>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</b>	

**Kriteri 1** Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;

**Kriteri 2** Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;

**Kriteri 3** Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;

**Kriteri 4** Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

**Konfirmojmë që:** Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas dhe të huaj;

**Konfirmojmë që:** AU ka marrëdhënie bashkëpunimi me DAR për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës profesionale të "Master profesional" në "Pedagogji" me profil "Didaktikë" dhe "Menaxhim arsimi".

**Konstatojmë që:** Departamenti harton një raport analitik në të cilin analizohen edhe përfitimet nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Në politikat e tij për zhvillim dhe përmirësim, AU, ka prioritet marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare. AU ka nënshkruar marrëveshje institucionale me disa prej IAL publike si dhe Drejtoritë Arsimore Rajonale si dhe institucione për organizimin e konferencave të përbashkëta, trajtimeve. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dypalëshe edhe me institucione ndërkombëtare si Univeristetin Sigmund Freud, Vjenë, Universitetin e Padovës, Aquilas.

Konfirmojmë që institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me DAR Tiranë për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale në këtë program studimi.

Mendojmë që institucioni duhet të angazhohet më tepër për realizimin e bashkëpunimeve dypalëshe me institucionet ndërkombëtare, ku në fokus duhet të jetë pjesëmarrja në projekte dhe mobiliteti i pedagogëve dhe studentëve.

Ka një lëvizje të institucionit në muajin mars 2019, për të bërë marrëveshje specifike dhe të balancuara me institucionet ku do të bëhet praktika, por kjo mbetet për tu parë më tej pasi aplikimi i tyre është ende potencial jo real.



## ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

### **I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË**

Në datat 24, 25 Prill 2019, u përmbush vizita në institucion konform agjendës. Leximi dhe hulumtimi i RVB, bashkebisedat e qëllimta me grupet specifike, stafi akademik, studentët, sekretaria, si dhe përgjegjësi i departamentit, na rezultojnë se përgjithësisht ka përputhje mes RVB dhe RVJ.

Programi “Master profesional” në “Pedagogji” me dy profile: “Diaktikë” dhe “Menaxhim Arsimi” thuhet se është zgjatim i programit Bachelor në mësuesi, psikologji edukimi, programe që janë gjeneruar ndër vite brenda institucionit. Ky fakt e konfirmon se parimi i koherencës vertikale mbi të cilin ndërtohet programi “Master profesional” në “Pedagogji” me dy Profile: “Didaktikë” dhe “Menaxhim Arsimi” mundet të funksionojë.

Për rekomandimin a), **Institucioni ka përmbushur këtë rekomandim.**

Për rekomandimin b), **Institucioni ka përmbushur pjesërisht këtë rekomandim.**

Për rekomandimin c), **Institucioni ka përmbushur pjesërisht këtë rekomandim.**

Për rekomandimin d), **Institucioni ka përmbushur cilësisht këtë rekomandim.**

Për rekomandimin e), **Institucioni ka përmbushur kryesisht këtë rekomandim.**

### **II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).**

#### **a. Pika të forta:**

1. Institucioni granton qëndrueshmëri për të përmbushur programin “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimi” në pikëpamjen administrative, nënkuptojmë, {godina, mjediset hapsinore ku përcillet dija akademike, kontratat afatgjata të stafit të brendshëm dhe të jashtëm, rregullsia në pagesat e stafit, logjistika, biblioteka}.
2. Studentët përbëjnë strukturë heterogjene dhe vijnë nga programe studimi Bachelor po nga Institucioni, {94 studentë nga Arsimi Fillor, 11 nga Arsimi Parashkollor, 45 studentë nga programet e studimit në Gjuhë Shqipe, Anglisht, Mësuesi Matematike, Filozofi, Biokimi, Frengjisht, Gjithësej 148 studentë dhe një student i transferuar}, pikenisje e mirë për diplomën “Didaktike”si dhe 41 studentë ndjekin profilin “Menaxhim arsimi”.
3. Vlerësimi periodik i programit përmbushet referuar instrumenteve dhe cdo i interesuar ka akses.
4. Njësia e sigurimit të cilësisë, sekretaria dhe stafi mbështetës kryejnë punë serioze dhe në respekt të parimeve etike.
5. Stafi akademik përmbush shkallën e kualifikimit dhe rezultojnë të përfaqësojë shkollën edukimi diverse.
6. Personelit akademik efektiv i angazhuar në këtë program studimi paraqet qëndrueshmëri vitet e fundit.

#### **b. Pika të dobëta:**

1. Studenti i diplomuar në profilin “Didaktikë” referuar dokumentacionit, ka një profil gjeneralist. Ndërkohë që pritshmëritë mund të jenë për diplomim si “ekspert në didaktikë”. Por, kjo pritshmëri vjen krejt e zbehtë përgjatë sylabuseve, Didaktika si shkenca e mësimdhënjes përfshirë taksonomitë, nuk del specifikisht, por “reduktohet” tek mësimdhënja, metodologjitë, pedagogjia.

2. Titulli i diplomës “Didakt” mbetet për tu analizuar në pikëpamjen e sylabuseve, ose duhet rikompozuar disiplina që përcjell didaktikën e përgjithshme në parimet, taksonomitë, ligjësite, konteksti. Didakti nuk është vetëm një mësues, përndryshe do të merrte diplomën e mësuesisë! Titulli i diplomës “Didakt” nuk ofrohet në listën e profesioneve të rregulluara, referuar ligjit nr. 10171, të datës 22.10. 2009. Rregullorja e programit të studimit dhe kontratat me studentët e kanë lënë jashtë këtë fakt.
3. Në marrvëshjet me institucionet e arsimit, mungojnë zëra konkretë që rregullojnë sistemin e mentorimit në shkollat ku përmbushet praktika profesionale për të dy profilet. {sistemi i mentorëve} është dhe pika e vështirë e përmbushjes së praktikave. Ende nuk ka përpjekje serioze për të pasur një sistem mentoresh.
4. Nuk konstatohet ende një përpjekje e qëllimtë e Departamentit për të inicuar një botim periodik me ISSN ku të fokusohen në shkencat e edukimit dhe didaktikë.
5. Titujt e literaturës në funksion të studentëve të programit të studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimit” për realizimin e projekteve kërkimore dhe realizimit të tezës së diplomës janë të reduktuar.
6. Aktualisht raporti i Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë me atë me kohë të pjesshme është 7/5 (58%/42%) nderkohë që për programet e studimeve të ciklit të dytë personeli akademik i punësuar me kohë të plotë duhet të përbëjë së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me dy profile. Numri i stafit akademik të brendshëm të angazhuar në këtë program studimi ka qënë më i lartë në periudhën 2014-2018, duke ruajtur një raport afër 70 %, e nga viti në vit ka ardhur në rënie.

#### **c. Mundësitë:**

1. Diploma e profilit “Didakt” paraqet mjaftueshëm interes. Didakti si gjeneralist, ekspert i çështjeve që fokusohet te shkencat e mësimit/taksonomive, mund të jetë trajner potencial në institucionet lokale të trajnimit. Perspektiva e këtij profili mund të jetë më ambicioze nëse shëndërrohet në program dy vjeçar Master profesional me 120 ECTS në funksion të profesionit të mesuesisë.
2. Rritja e numrit të personelit akademik efektiv për realizimin e programit “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimit”.

#### **d. Pëngesat:**

1. Aktualisht, mungon një interesim i posaçëm, i qëllimtë për didaktikën dhe didaktin. Intresat e eksperteve për “Didaktin” duhen elaboruar më shumë në mediumet akademike në institucionet e larta të edukimit, kjo lypset të jetë një nga ambiciet e këtij programi.
2. Programi i studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë”, nuk specifikon ciklin dhe disiplinën në të cilin do të zhvillojë mësimit studentin e diplomuar.
3. Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 48/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, për sistemin arsimor parauniversitar”, zhvillimi profesional dhe trajnimi i drejtuesëve dhe administratorëve të shkollës do të realizohet nëpërmjet Shkollës së Drejtorëve.

#### **Rekomandimet**

1. Të identifikohet një projekt buxhet për kërkimin shkencor, që të lartësojë emrin e programit në fjalë, elaborojë, kompetencat profesionale kyc dhe fushat e veprimtarisë.
2. Të skicohet “profili” i didaktit dhe të elaborohet nevoja e tregut për didakt, ku të specifikohet cikli dhe disiplina në të cilin do të zhvillojë veprimtarinë studentin e diplomuar. Kjo të bëhet pjesë e rregullores dhe kontratës me studentët që ndjekin programin.

3. Të hartohet një plan strategjik për zhvillimin e programit të studimit, ku të përcaktohet qartë për secilin profil: misioni, vizioni, objektivat, tregu i punës, sfidat, perspektivat, inisiativat strategjike.
4. Të rishikohet kurrikula dhe të ristrukturohen kurset e veprimtarisë formuese B për secilin profilin, në bazë të objektivave të ndryshme formuese që ato kanë.
5. Të vihet në dispozicion një fond më i zgjeruar bibliografik në funksion të studentëve të programit të studimit “Master profesional” në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimit” për realizimin e projekteve kërkimore dhe realizimit të tezës së diplomës

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm**

Prof.As.Dr. Mariana Sinani

Dr. Dilina Beshiri

## SUMMARY ANALYSIS FOR THE EVALUATION OF THE STUDY PROGRAM

### I. SUMMARY ANALYSIS OF FULFILLMENT OF RECOMMENDATIONS FROM THE FIRST ACCREDITATION

1. For recommendation a), The recommendation is met.
2. For recommendation b), The recommendation was partially met by the institution.
3. For recommendation c), The recommendation was partially met by the institution.
4. For recommendation d), The recommendation was fully met.
5. For recommendation e), The recommendation was substantially met by the institution.

### II. SUMMARY ANALYSIS OF THE RVJ BY SWOT METHOD (STRENGTHS, WEAKNESSES, OPPORTUNITIES, THREATS).

#### a. Strengths:

1. The institution ensures consistency to accomplish the program of "Professional Master" in "Pedagogy" with the "Didactics" and "Education Management" profile in an administrative point of view, here we mean: (buildings, space environments where academic knowledge is transmitted, long-term contracts with full time and part-time staff, regularity in staff payments, logistics, library).
2. Students constitute a heterogeneous structure and come from Bachelor study programs from the Institution, (94 students from Primary Education, 11 from Pre-School Education, 45 students from Albanian Language, English, Maths' Teacher, Philosophy, Bio-chemistry, French, in total 148 students and 1 student transferred), good start for diploma in "Didactics", as well as 41 students attend "Education Management" profile.
3. Periodical evaluation of the program is accomplished referring to the instruments and anyone interested has access.
4. The Quality Assurance Unit, the secretary and supporting staff perform serious work in respect to ethical principles.
5. The academic staff fulfills the degree of qualification and turns out to represent diverse schools of education.
6. The effective academic staff involved in this study program represents sustainability in the recent years.

#### b. Weaknesses:

1. A graduate student in the "Didactics" profile referring to the documentation has a general profile. Meanwhile, there can be expectations for graduation as "expert in didactics". But, this expectation comes quite dim along the syllabi, Didactics as teaching science, including taxonomies, does not specifically appear but "is reduced" to teaching, methodologies, pedagogy.
2. The title of the diploma "Didact" remains to be analyzed in syllabus's view, or the discipline should be recompiled that forwards the general didactics in principles, taxonomies, nomocracy, and context. The didact is not just a teacher, otherwise s/he would take the degree of teaching! "Didact" diploma is not provided in the list of

regulated professions, referred to Law no. 10171, dated 22.10. 2009. The regulation of the study program and contracts with students have left this fact out of the question.

3. In the agreements with the education institutions, there are no concrete voices regulating the mentoring system in schools where professional practices for both profiles are met (mentors' system) is also the hardest point of doing the practice/ practicum. There is still no serious effort to have a mentoring system.
4. It is not yet established a deliberate attempt of the Department to initiate a periodic publication with ISSN, focusing on education and didactics sciences.
5. Literature titles for the students of the "Professional Master" study program in "Pedagogy" with the "Didactics" and "Education Management" profiles for the fulfillment of research projects and the completion of the Bachelor's thesis are reduced.
6. Currently, the ratio of full-time and part-time full-time academic staff is 7/5 (58% / 42%), whereas full-time academic staff for the second cycle study programs should constitute at least 70% of the academic staff engaged in the realization of the "Professional Master" study program in "Pedagogy" with two profiles. The number of full time academic staff engaged in this study program has been higher in the period 2014-2018, maintaining a ratio of close to 70%, and year after year has decreased.

**c. Opportunities:**


1. The diploma with the profile "Didact" has got enough interest. Didact as a generalist, an expert on issues that focus on science of teaching / taxonomies, can be potential trainer in local training institutions. The perspective of this profile may be more ambitious if it becomes a two-year Professional Master's program with 120 ECTS in function of the Teaching profession.
2. Increasing the number of effective academic staff for the implementation of the "Professional Master" program in "Pedagogy" with the "Didactics" and "Education Management" profiles.

**d. Threats:**

1. Currently, there is a purposeful lack of special interest in didactics and didact. Experts' interests for "Didact" should be elaborated more in academic media at higher education institutions, which should be one of the ambitions of this study program.
2. The "Professional Master" study program in "Pedagogy" with the "Didactics" profile does not specify the cycle and discipline in which the graduate student will be taught.
3. With the entry into force of Law no. 48/2018 "On some additions and amendments to law no. 69/2012, for the pre-university education system", the professional development, training and certification of school principals and administrators will be implemented through the School of Directors/ Headmasters.

**Recommendations:**

1. To Identify a project budget for research in order to enhance the name of the program in question, elaborate key professional competences and areas of activity.



2. To Sketch the didact "profile" and elaborate the market need for a didact, specifying the cycle and discipline in which the graduate will develop the activity. This becomes part of the regulation and contract with the students who attend the program.
3. To Develop a strategic plan for the development of the study program, where it is clearly defined for each profile: mission, vision, objectives, labor market, challenges, perspectives, strategic initiatives.
4. Review the curriculum and restructure formative courses for each profile, based on the different formative objectives they have.
5. To provide a more extensive bibliography fund for the students of the "Professional Master" study program in "Pedagogy" with the "Didactics" and "Education Management" profiles for the realization of research projects and the completion of the diploma thesis.

**External Evaluation Group**

Prof.As.Dr. Mariana Sinani

Dr. Dilina Beshiri